



Funded by
the European Union

Politika e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë Mësimet për planet për 2030



Politika e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë

Mësimet për planet për 2030

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive

Hyrje

Caqet e përgjithshme të energjisë së ripërtëritshme për 2020

Planet kundrejt realitetit për vitin 2020

Perspektiva e vitit 2030 - çfarë pritet nga Kosova?

Konkluzione dhe rekomandime

Përmbledhje ekzekutive

Kosova, si Palë Kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe shtet që aspiron anëtarësim në Bashkimin Evropian, është e detyruar të ndjekë politikën e BE-së për energji dhe mjedis e cila ka një cak të deklaruar qartas të dekarbonizimit të ekonomisë më së voni deri në vitin 2050, si dhe caqe të tjera më ambicioze për energjinë e ripërtëritshme, efikasitetin e energjisë dhe uljen e gazrave serrë. Në dy vitet e fundit, BE-ja ka rritur përpjekjet e saj në këtë fushë përmes Marrëveshjes së Gjellbër Evropiane dhe aktualisht është në proces të dakordimit të caqeve më ambicioze se ato fillimisht planifikuara për 2030.¹

Në nëntor të vitit 2020, shtetet e Ballkanit Perëndimor nënshkruan Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor,² duke ankoruar zotimin e tyre për të ndjekur rrugën e BE-së dhe, në veçanti, miratimin e Ligjit të Klimës të BE-së, i cili është në proces të finalizimit.

Kështu, Kosova është në ndjekje të një caku të lëvizshëm dhe do të duhet të vrapojë shpejt për ta arritur. Aktualisht, Kosova është në proces të hartimit të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) për 2030, dhe përcaktimit të caqeve për energji të ripërtëritshme, efikasitetin e energjisë dhe reduktim të gazrave serrë.

This paper examines Kosovo's experience from its previous renewable energy target for 2020, and seeks to provide insights on how the planning process needs to be changed.

Ky dokument shqyrton përvojën e Kosovës me cakun e mëparshëm të energjisë së ripërtëritshme për vitin 2020 dhe ka për qëllim t'i paraqesë ndryshimet e nevojshme për procesin e planifikimit.

Si palë kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Kosova u zotua në vitin 2012 që të arrijë cakun prej 25 për qind të konsumit të saj të përgjithshëm të energjisë nga burimet e ripërtëritshme deri më 2020, duke përfshirë 10 për qind të energjisë së ripërtëritshme në transport.

Ende nuk ka në dispozicion të dhënat përfundimtare për vitin 2020, por të dhënat e vitit 2019 tregojnë se Kosova me shumë gjasë e ka përmbushur këtë cak. Por, kjo ka ndodhur më shumë rastësisht se me paramendim, për shkak të rishikimit të të dhënave të biomases. Pothuajse nuk është bërë fare progres në drejtim të përmbushjes së caktuar për energji të ripërtëritshme në transport, një sektor në të cilin plani i vetëm ishte rritja e përdorimit të biokarburanteve të importuara. Kosova e Re coal-fired power plant. Only in the last three or four years have wind and solar started to take off.

Planet e Kosovës për të rritur përqindjen e saj të energjisë së ripërtëritshme në sektorin e energjisë elektrike mbështeten në masë të madhe në hidrocentralet e vogla, nga të cilat pritej të shtoheshin jo më pak se 177 MW kapacitet deri më 2020.

Në realitet, deri në vitin 2019 nëntë centrale me kapacitet prej 50 MW pranonin tarifa nxitëse për burime të ripërtëritshme, por ato nuk arritën të prodhojnë sasi të konsiderueshme të energjisë elektrike (vetëm 2.3 për qind më 2019) dhe shkaktuan dëme serioze mjedisore dhe protesta publike.

Përkundër rishikimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Energji të Ripërtëritshme më 2018, Kosova nuk arriti të ndërtojë kapacitete solare, të erës ose hidrocentrale të vogla sa ishte planifikuar fillimisht, dhe që nga viti 2019 kishte arritur të sigurojë vetëm 5.15 për qind të energjisë elektrike të ripërtëritshme - më pak se çdo shtet tjetër anëtar i Komunitetit të Energjisë, përveç Moldavisë.

¹ Komisioni Evropian, *Komisioni mirëpret marrëveshjen e përkohshme për Ligjin Evropian të Klimës*, 21 prill 2021.

² *Deklarata e Sofjes për Agjendën e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor*, 10 nëntor 2020.

Periudha nga vendosja e caktimit të energjisë së ripërtëritshme më 2012 deri në vitin 2020 u karakterizua me anashkalim të vazhdueshëm të energjisë së ripërtëritshme dhe fokus në planet për termocentralin me thëngjill Kosova e Re. Kapacitetet solare dhe të erës kanë filluar të shtohen vetëm tri apo katër vitet e fundit.

Ndërsa tani fillon vendosjen e caqeve dhe planifikimin e energjisë deri në vitin 2030, Kosova mund, dhe duhet, të mësojë nga përvoja e saj deri më 2020, në mënyrë që ta përshpejtojë tranzicionin e saj dhe të sigurohet që kjo pranohet gjerësisht nga publiku. Ky dokument i pozicionit paraqet një sërë rekomandimesh bazuar në përvojën e tetë viteve të fundit, veçanërisht me skemën e tarifave nxitëse për burimet e ripërtëritshme që janë miratuar për të mbështetur zhvillimin e energjisë së ripërtëritshme.

Këto rekomandime përfshijnë nevojën për t'i vendosur konsideratat e qëndrueshmërisë mjedisore në thelb të planifikimit të energjisë së ripërtëritshme dhe për të siguruar që edhe ngrohja, transporti dhe sektori i energjisë janë planifikuar në nivel të njëjtë. Gjithashtu, janë të nevojshme ndryshime legjislative për të siguruar që familjet mund të përfitojnë drejtpërdrejt nga energjia e ripërtëritshme dhe për t'u siguruar që energjia e prodhuar nuk është vetëm e ripërtëritshme por edhe e qëndrueshme nga ana mjedisore dhe ekonomike.

Hyrje

Kosova, si palë kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë dhe shtet që aspiron anëtarësim në BE, është e detyruar t'i ndjekë politikat e BE-së për energji dhe mjedis. Megjithatë, kjo nuk është vetëm çështje detyrimi, por është edhe e dëshirueshme për shkak të shëndetit publik dhe përfitimeve mjedisore që sjell.

Në dy vitet e fundit, BE-ja ka rritur përpjekjet e saj në këtë fushë përmes Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane dhe aktualisht është në proces të dakordimit të caqeve më ambicioze se ato fillimisht planifikuara për 2030. Në prill të vitit 2021, Parlamenti Evropian dhe Këshilli Evropian u dakorduan jozyrtarisht për uljet e emetimeve të gazrave serrë për 55 për qind krahasuar me nivelet e vitit 1990 - nga zotimi ekzistues prej 40 për qind. Energjia e ripërtëritshme dhe caqet për efikasitet të energjisë do të diskutohen edhe më tej si pjesë e Direktivave të rishikuara të Energjisë së Ripërtëritshme dhe Efikasitetit të Energjisë.³

Në nëntor të vitit 2020, shtetet e Ballkanit Perëndimor nënshkruan Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor,⁴ duke ankoruar zotimin e tyre për të ndjekur agjendën e BE-së dhe, në veçanti, miratimin e Ligjit të Klimës të BE-së, i cili është në proces të finalizimit.

Kështu, Kosova është në ndjekje të një caku të lëvizshëm dhe do të duhet të vrapojë shpejt për ta arritur. Aktualisht, Kosova është në proces të hartimit të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (PKEK) për 2030, dhe përcaktimit të caqeve për energji të ripërtëritshme, efikasitet të energjisë dhe reduktim të gazrave serrë.

Ky dokument shqyrton përvojën e Kosovës me vendosje të caqeve të mëparshme të energjisë së ripërtëritshme më 2012 deri më 2020 dhe ka për qëllim t'i paraqesë ndryshimet e nevojshme për procesin e planifikimit.

³ Komisioni Evropian, [Komisioni mirëpret marrëveshjen e përkohshme mbi Ligjin Evropian të Klimës . . . 21 Prill 2021](#), [Sofia Declaration on the Green Agenda for the Western Balkans, 10 November 2020](#).

⁴ [Deklarata e Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, 10 nëntor 2020](#).

Caqet e përgjithshme të burimeve të ripërtëritshme për 2020

Tradicionalisht, Kosova ka qenë pothuajse tërësisht e varur nga linjiti për prodhimin e saj të energjisë. Megjithatë, për shkak të nevojës për zgjerim të kapaciteteve, si dhe për një sistem të shëndetshëm dhe më fleksibil të energjisë, viteve të fundit ajo ka filluar të zhvillojë më shumë burime të ripërtëritshme të energjisë.

Si palë kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, Kosova u detyrua ta rrisë pjesën e saj të energjisë së ripërtëritshme më 2012, kur Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë mori vendim për miratimin e caqeve të energjisë së ripërtëritshme për vitin 2020, duke përdorur vitin 2009 si viti bazë.

Direktiva origjinale e Energjisë së Ripërtëritshme e vitit 2009 (2009/28/KE) përcaktonte një cak në nivel të BE-së prej 20 për qind të energjisë së ripërtëritshme në konsumin përfundimtar bruto të energjisë (jo të energjisë elektrike) të ndarë në caqe kombëtare në varësi të pikënisjes së secilit shtet.

Më vonë u zhvilluan caqet specifike për shtetet e Ballkanit Perëndimor. Meqë këto caqe bazoheshin në pozicionin fillestar të shteteve më 2009, disa prej caqeve duken mjaft të larta krahasuar me synimin e përgjithshëm të BE-së prej 20 për qind, veçanërisht sepse vendet e Ballkanit kishin nivele mjaft të larta të energjisë së ripërtëritshme për të filluar në krahasim me shumë vende të BE-së. Përdorimi i biomasës së drurit për ngrohje është i përhapur⁵ dhe shumica e vendeve - ndonëse jo Kosova - kanë nivele të larta të hidroenergjisë në totalin e tyre të energjisë elektrike.⁶ Pra, edhe pse caqet mund të duken të larta, ato nuk ishin veçanërisht ambicioze në krahasim me situatën bazë.

Përkundër kësaj, disa vende kanë pasur vështirësi në përmbushjen e tyre. Deri në maj të vitit 2021, ende ishin të disponueshme shifrat përfundimtare të vitit 2020, por ato të vitit 2019 japin indikacione të mira të progresit të vendeve (shih Tabelën 1, më poshtë).

Mali i Zi dhe Kosova duket se kanë përmbushur objektivat e tyre të vitit 2020 deri në vitin 2019, por kjo arritje e madhe duhet të shihet me kujdes. Në të dyja rastet, Komuniteti i Energjisë ia ka atribuar rritjen e përpjesës së energjisë së ripërtëritshme rregullimit të statistikave për përdorimin e biomasës, dhe jo investimeve të konsiderueshme në burimet e ripërtëritshme.⁷

Shqipëria dhe Bosnja e Hercegovina me shumë gjasë nuk i kanë përmbushur caqet e tyre, ndërsa Serbia dhe Maqedonia e Veriut ishin shumë larg përmbushjes së caqeve të tyre deri më 2019. Maqedonia e Veriut ishte shteti i parë në Ballkanin Perëndimor që hapi një fermë ere në shkallë të madhe, në vitin 2015,⁸ por progresi i saj u shoqërua me ngecje për disa vjet. Serbia filloi vonë por kishte instaluar gati 400 MW të kapacitetit të erës deri më 2020. started late but had installed almost 400 MW of wind capacity by 2020.⁹

⁵ Banka Botërore ka vlerësuar se në përgjithësi në rajonin e Ballkanit Perëndimor, biomasa përbën 42% të energjisë së nevojshme për ngrohje. Burimi: Banka Botërore, Kuadri i Investimeve në Ballkanin Perëndimor, Komuniteti i Energjisë, *Ngrohja e Bazuar në Biomasë në Ballkanin Perëndimor - Udhërrëfyes për raportin përfundimtar të zhvillimit të qëndrueshëm, 2017.*

⁶ Për një përmbledhje të burimeve energjetike në shtete, shihni:
<https://bankwatch.org/beyond-coal/energy-sector-in-albania>
<https://bankwatch.org/beyond-coal/the-energy-sector-in-bosnia-and-hercegovina>
<https://bankwatch.org/beyond-coal/the-energy-sector-in-kosovo>
<https://bankwatch.org/beyond-coal/the-energy-sector-in-montenegro>
<https://bankwatch.org/beyond-coal/the-energy-sector-in-macedonia>
<https://bankwatch.org/beyond-coal/the-energy-sector-in-serbia>

⁷ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, *Raporti i Zbatimit 2020, nëntor 2020, f.90 dhe 130.*

⁸ Igor Todoroviç, *Bogdanci, ferma me erë 36.8 MW fillon operimin e rregullt, Balkan Green Energy News, 5 korrik 2015.*

⁹ *Odluka o utvrđivanju energetska bilansa Republike Srbije za 2021. godinu, Sl. glasnik RS, no. 156/2020.*

Tabela 1: Caqet e energjisë së ripërtëritshme për shtetet e Ballkanit Perëndimor për vitin 2020 dhe 2019

Shteti	Pjesa e burimeve të ripërtëritshme për 2009, % ¹⁰	Caqet e vitit 2020, % ¹¹	Pjesa e burimeve të ripërtëritshme 2019, % ¹²
Shqipëri	31.2	38	36.67
Bosnjë dhe Hercegovinë	34.0	40	37.58
Kosovë	18.9	25	25.69
Mal i Zi	26.3	33	37.37
North Macedonia	21.9, më vonë u ul në 17.2 ¹³	28, më vonë u ul në 23 ¹⁴	16.81
Serbi	21.2	27	21.44

Burimi: Komuniteti i Energjisë dhe Eurostat

Caku i energjisë së ripërtëritshme për secilin shtet për vitin 2020 përbëhej nga tri nën-caqe - për sektorin e energjisë, për ngrohjen dhe ftohjen, si dhe për transportin. Nga këto, vetëm caku i transportit ishte detyrues. Nën-caqet për ngrohje/ftohje dhe energji mund të rregullohen sipas nevojës për të përmbushur cakun e përgjithshëm.

Kosova vendosi caqet sipas Tabelës 2 në vitin 2013, dhe më pas i përditësoi më 2018. Deri më 2019, përqindja e energjisë së ripërtëritshme në sektorin e ngrohjes dhe ftohjes ishte më e lartë se që ishte planifikuar, dhe përbëhej pothuajse tërësisht nga biomasa pyjore. Siç u përmend më lart, kjo nuk ishte falë investimeve, por më tepër pasojë e rishikimit të të dhënave të biomases në nivel vendi.¹⁵

Por, përqindja në sektorin e energjisë dhe transportit ishte shumë më e ulët. Në fakt, përqindja në sektorin e transportit ishte zero.

	Nën-caqet e vendosur më 2013, % ¹⁶	Nën-caqet e vendosur më 2018, % ¹⁷	Pjesa e energjisë së ripërtëritshme më 2019, % ¹⁸
Energji elektrike	25.64	14.6	36.67
Ngrohje dhe Ftohje	45.65	44.4	37.58
Transporti	10	10	25.69

Table 2: Kosovo's renewable energy sub-targets for 2020 and 2019 gets for 2020 and 2019 share

Kosova nuk ishte i vetmi vend i Ballkanit Perëndimor që bëri pak progres në përdorimin e energjisë së ripërtëritshme në transport gjatë kësaj periudhe - secili shtet në rajon, përveç Serbisë, kishte më pak se 1 për qind të transportit në operim përmes energjisë së ripërtëritshme në vitet e fundit. Shqipëria ka rritur përdorimin e saj të biokarburanteve, por nuk ka transpozuar kriteret e qëndrueshmërisë së BE për të siguruar që ato nuk kanë ndikim të madh në prodhimin e ushqimit ose në biodiversitet.¹⁹

¹⁰ Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë: [Vendimi 2012/04/MC-EnC, 18.10.2012](#)

¹¹ Këshilli Ministror i Komunitetit të Energjisë: [Vendimi 2012/04/MC-EnC, 18.10.2012](#)

¹² Të dhënat për 2020 nuk janë ende në dispozicion, në kohën e hartimit të këtij raporti, në maj 2021. Të gjitha të dhënat në këtë kolonë janë nga Eurostat, [Tabela NRG_IND_REN_përditësimi_i_fundit: 2 prill 2021](#)

¹³ Komuniteti i Energjisë: [Vendimi 2018/02/MC-EnC për ndryshimin e Vendimit 2012/04/MC-EnC](#)

¹⁴ Komuniteti i Energjisë: [Vendimi 2018/02/MC-EnC për ndryshimin e Vendimit 2012/04/MC-EnC](#)

¹⁵ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, [Raporti i Zbatimit 2020, nëntor 2020, f. 90](#)

¹⁶ Ministria e Zhvillimit Ekonomik, [Kosovë: Plani Kombëtar i Veprimtërisë për Energjinë e Ripërtëritshme 2011-2020, 2013](#)

¹⁷ Qeveria e Kosovës: [Plani Kombëtar i Veprimtërisë për Energjinë e Ripërtëritshme të Republikës së Kosovës 2011-2020, përditësuar për 2018-2020, tetor 2018](#). (Në dokument shkruan maj 2020, por nga burime të tjera është e qartë se ai u miratua në tetor 2018).

¹⁸ Kosova, [Raporti i katërt i Progresit për promovimin dhe përdorimin e energjisë nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, 2018-2019, 9 shkurt 2021](#)

¹⁹ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, [Raporti vjetor i Zbatimit, nëntor 2020](#)

Për më tepër, vetë BE-së i është dashur t'i zbusë politikat e veta në këtë fushë. Direktiva e vitit 2009 për energjinë e ripërtëritshme²⁰ inkurajoi përdorimin e biokarburanteve, në kushtet e disa kriterëve të qëndrueshmërisë. Megjithatë, përvoja ka treguar se prodhimi i karburanteve nga të korrat çon në shpyllëzim dhe rritje të presionit në burimet e tokës, si dhe në inflacion potencial të çmimeve të ushqimeve.²¹

Në fund të vitit 2018, BE-ja miratoi një Direktivë të përditësuar të Energjisë së ripërtëritshme (REDII).²² REDII praktikisht ngrin përdorimin e biokarburanteve me bazë në të korra në transportin rrugor dhe hekurudhor në nivelet e përdorura nga secili shtet anëtar i BE në vitin 2020, e që në asnjë rast nuk duhet të kalojë 7 për qind.²³ Direktiva e Energjisë së Ripërtëritshme do të rishikohet përsëri gjatë vitit 2021 dhe organizatat mjedisore si Transporti & Mjedisi po përpiqen të kufizojnë më tej përdorimin e biokarburanteve në mënyrë që të frenojnë ndikimin e tyre në mjedis dhe efektet në përdorimin e tokës për prodhim të ushqimit.²⁴

Për shkak të këtyre ndikimeve dhe ndryshimeve në politika, rritja e përdorimit të energjisë së ripërtëritshme në transport ka qenë relativisht e ngadaltë. Deri më 2019, BE-ja kishte arritur 8.4 për qind, duke bërë që caku prej 10 për qind të jetë gati i pamundur.²⁵ Për këto arsye, e konsiderojmë se është e kuptueshme që vendet e Ballkanit Perëndimor nuk kanë arritur progres të madh.

Edhe pse ky cak ishte i detyrueshëm, dhe me këtë dështimi për ta përmbushur atë përbënte shkelje të Traktatit të Komunitetit të Energjisë, nga një këndvështrim mjedisor mund të ketë qenë përparësi që shtetet ishin të ngadalta për të lëvizur në këtë fushë. Përvoja nga BE-ja mund t'i ndihmojë vendet e Ballkanit Perëndimor që t'i shmangin gabimet e kushtueshme dhe t'i ndihmojë ata të kalojnë menjëherë te zgjidhjet që janë vërtetë të qëndrueshme

Megjithatë, e njëjta gjë nuk mund të thuhet për sektorin e energjisë elektrike. Shumë vende të BE-së janë duke kaluar në përqindje të larta të energjisë së ripërtëritshme në konsumin e energjisë. Në vitin 2019, BE-ja, si tërësi, arriti më shumë se 34 për qind të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme,²⁶ ku Suedia dhe Austria arrinin mbi 70 për qind, madje dhe Gjermania e Rumania me kapacitete të mëdha thëngjilli arritën mbi 40 për qind.²⁷

Nga të gjitha vendet e mbuluara nga Eurostat, të cilat përfshijnë BE-në, Zonën Ekonomike Evropiane (ZEE) dhe vendet e Komunitetit të Energjisë, vetëm Moldavia kishte përqindje më të ulët të konsumit të energjisë së ripërtëritshme sesa Kosova në 2019.²⁸

Është e qartë se vendet e BE dhe ZEE kishin një fillim më të hershëm sesa Kosova dhe kanë më shumë burime, por prapë duhet të shtrohet pyetja: Pse Kosova kishte arritur vetëm 5.15 për qind të energjisë elektrike të pyetja deri më 2019, përkundër faktit se çmimet e kapaciteteve me erë dhe solare kanë rënë me shpejtësi gjatë dekadës së fundit?²⁹

²⁰ Direktiva 2009/28/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 prillit 2009 mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme dhe ndryshimin dhe shfuqizimin e Direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE.

²¹ Agjencia Evropiane e Mjedisit, vlerësimi i treguesve, *Përdorimi i karburanteve të ripërtëritshme në transport në Evropë*, 17 dhjetor 2019.

²² Direktiva (BE) 2018/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 dhjetorit 2018 mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme.

²³ Neni 26.

²⁴ Transporti dhe mjedisi, *cili është problemi dhe si mund ta rregullojmë atë?.. pa datë, shikuar për herë të fundit më 30 maj 2021*.

²⁵ Agjencia Evropiane e Mjedisit, *Përdorimi i energjisë së ripërtëritshme për transportin në Evropë*, 8 dhjetor 2020.

²⁶ Të dhënat për 2020 nuk janë ende në dispozicion, në kohën e hartimit të këtij raporti, në maj 2021. Të gjitha të dhënat në këtë kolonë janë nga Eurostat, *Tabela NRG_IND_REN_përditësimi i fundit: 2 prill 2021*

²⁷ Të dhënat për 2020 nuk janë ende në dispozicion, në kohën e hartimit të këtij raporti, në maj 2021. Të gjitha të dhënat në këtë kolonë janë nga Eurostat, *Tabela NRG_IND_REN_përditësimi i fundit: 2 prill 2021*

²⁸ Të dhënat për 2020 nuk janë ende në dispozicion, në kohën e hartimit të këtij raporti, në maj 2021. Të gjitha të dhënat në këtë kolonë janë nga Eurostat, *Tabela NRG_IND_REN_përditësimi i fundit: 2 prill 2021*

²⁹ IRENA, *Kostot e Prodhimit të Energjisë së Ripërtëritshme më 2019*, qershor 2020

Planet kundrejt realitetit për vitin 2020

Planet e veprimit për energji të ripërtëritshme të Kosovës dhe masat nxitëse për energjinë e ripërtëritshme

Me Direktivën e Energjisë së Ripërtëritshme 2009,³⁰ nga secili shtet u kërkuar të zhvillojë një Plan Kombëtar të Veprimit për Energjinë e Ripërtëritshme (PKVER)³¹ dhe të ndërmarrë hapa për të mundësuar zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë³². Stimujt financiarë për investitorët në energjinë e ripërtëritshme, siç janë tarifatat nxitëse (feed-in), nuk ishin të detyrueshme³³, por janë parë në Direktivë si një mënyrë për t'i inkurajuar investitorët. Në vitin 2013, Kosova zhvilloi PKVER-në e parë, në të cilin detajohej përqindja e pritur

Në vitin 2013, Kosova zhvilloi PKVER-në e parë,³⁴ në të cilin detajohej përqindja e pritur e secilit burim energjie që do të arrihej deri në vitin 2020. Në vitin 2017, u bënë rregullime në proporcionin e secilit lloj të energjisë që do të pranonte tarifa nxitëse (shih më poshtë) dhe i tërë PKVER u përditësuar më 2018. Megjithatë, edhe me rregullime, arritjet e Kosovës deri më 2019 nuk korrespondojnë me planin. Në këtë pjesë, ne do të shohim se çfarë mund të mësohet nga kjo në planifikimin për vitin 2030.

Ndryshe nga shumica e qeverive në rajon, Kosova vendosi një cak më të lartë kombëtar të energjisë së ripërtëritshme sesa ai detyruar i dakorduar me Komunitetin e Energjisë, i cili ishte 25 për qind deri më 2020. Ndërkohë, Kosova vendosi një objektiv kombëtar prej 29.47 për qind, i cili u rrit në 29.89 për qind në 2017.³⁵

Në sektorin e ngrohjes, pjesa më e madhe e kontributit të burimeve të ripërtëritshme pritej të vinte nga biomasa, veçanërisht nga drutë e zjarrit për ngrohje familjare, me sasi shumë të vogla nga pompat e nxehtësisë dhe ato termike solare.³⁶ Kjo ishte problematike, meqë përdorimi i drurit rezultoi në shpyllëzim të pakontrolluar në Kosovë dhe gjithashtu kontribuoi në ndotje të ajrit, veçanërisht meqë shumë njerëz përdorin dru të prerë të njomë, në vend të druve të tharë.

Mospërputhja midis statistikave mbi furnizimet direkte të biomasës drusore nga pyjet dhe atyre në konsumin e biomasës sugjerojnë që 40 për qind e pyjeve publike dhe 30 për qind e pyjeve private janë subjekt i aktiviteteve të pakontrolluara dhe të paligjshme, përfshirë të prerjeve.³⁷

Edhe pse Kosova ishte duke konsideruar vendosjen e një detyrimi për operatorët e ngrohjes qendrore për të përfshirë një përqindje të caktuar të energjisë së ripërtëritshme në operacionet e tyre, nuk kishte pritje që ngrohja qendrore të kontribuonte deri në vitin 2020.³⁸

Në sektorin e transportit, i tërë kontributi i burimeve të ripërtëritshme pritej të vinte nga bioetanol dhe bionafta e importuar, dhe asnjë nga energjia e ripërtëritshme.³⁹

Në sektorin e energjisë elektrike, Qeveria e Kosovës u përqendrua në burimin që tashmë e kishte më të njohur: hidroenergjinë. Kosova ka potencialin më të vogël të hidrocentraleve në rajon,⁴⁰ por kjo nuk e ndali një valë hidrocentralesh të reja që janë duke u ndërtuar. Së paku 86 për qind e kapacitetit të instaluar të energjisë së ripërtëritshme pritej të vinte nga hidrocentralet.⁴¹

³⁰ Direktiva 2009/28/KE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 23 prillit 2009 mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme dhe ndryshimin dhe shfaqimin e Direktivave 2001/77/KE dhe 2003/30/KE.

³¹ Neni 4.

³² Neni 3.2

³³ Neni 3.3. Thekson se "Për t'i përmbyshur caqet e vendosura në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni, Shtetet Anëtare, mes tjerash, mund t'i zbatojnë masat vijuese: (a) skemat e mbështetjes;..." (Theksi është shtuar)

³⁴ Ministria e Zhvillimit Ekonomik, *Kosovë: Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Ripërtëritshme 2011-2020, 2013.*

³⁵ Ministria e Zhvillimit Ekonomik, *Kosovë: Udhëzimi Administrativ (MZHE) nr. 05/2017 për Caqet e Burimeve të Energjisë së Ripërtëritshme*

³⁶ Ministria e Zhvillimit Ekonomik, *Kosovë: Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Ripërtëritshme 2011-2020, 2013, f. 59.*

³⁷ Ministria e Ekonomisë dhe Mjedisit, *Raporti i 4-të i Progresit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë në Republikën e Kosovës 2018-2019 Sipas Direktivës së Energjisë së Ripërtëritshme 2009/28/KE, të miratuar me Vendim të Këshillit Ministror 2012/04/MC-EnC të Komunitetit të Energjisë, shkurt 2021, f.24.*

³⁸ Ministria e Zhvillimit Ekonomik, *Kosovë: Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Ripërtëritshme 2011-2020, 2013, f. 24 dhe 59.*

³⁹ Ministria e Zhvillimit Ekonomik, *Kosovë: Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Ripërtëritshme 2011-2020, 2013, f. 60.*

⁴⁰ Konsorciumi Mott MacDonald/IPF, *Strategjia Rajonale për Hidroenergji të Qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor, Raporti Historik Nr. 1 Roli i kaluar, i tonishëm dhe i ardhshëm i hidroenergjisë, drafti final, WBIF, 3 nëntor 2017, f.43*

⁴¹ Ministria e Zhvillimit Ekonomik, *Kosovë: Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Ripërtëritshme 2011-2020, 2013.*

Tabela 2: Planet e sektorit të energjisë në Kosovë për energjinë elektrike të ripërtëritshme krahasuar me vitin bazë 2009, PKVER i parë, 2013⁴²


	2009 MW	2009 GWh	Caku 25%		Caku 29.47 %	
			2020 MW	2020 GWh	2020 MW	2020 GWh
Burimi i energjisë	45.84	128.94	447.84	965.4	590.84	1608.9
Hidroenergjia	1.76	9.14 ⁴³	8.76	47.89	16	87.47
<1 MW	9.08	31.9	99.08	441.51	234.84	1045.43
>10 MW	35	87.9	340	476	340	476
Fotovoltaike solare	0	0	5	10.3	10	20.59
Erë	0	0	62.15	125.22	150	302.2
Biomasa e ngurtë	0	0	5	37.5	14	105
Gjithsej	45.84	128.94	519.99	1138.42	764.84	2036.69

Burimi: PKVER, Kosovë 2013

Shumica e kapacitetit të hidrocentraleve është pritur të vinte nga Zhuri 1 dhe 2, që ishin parashikuar të shtonin deri rreth 300 MW. Ishin planifikuar edhe së paku 97 MW të kapaciteteve të reja të vogla të hidrocentraleve për të përmbushur cakun prej 25 për qind, dhe rreth 225 MW të kapaciteteve të reja të vogla shtesë të hidroenergjisë për të përmbushur cakun më të lartë kombëtar prej 29,47 për qind. Sidoqoftë, këto vlerësime nuk ishin reale.

Zbatimi i shumicës së burimeve të ripërtëritshme në sektorin e energjisë filloi ngadalë. Siç shihet në grafikun më poshtë (shih Figurën 1), deri më 2016, kishte një rritje të vogël të hidroenergjisë. Sidoqoftë, burimet e tjera

Figura 1: Përzjerja e energjisë elektrike në Kosovë dhe importet neto



Burimi: Statistikat e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë

⁴² Ministria e Zhvillimit Ekonomik, *Kosovë: Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Ripërtëritshme 2011-2020, 2013.*

⁴³ 2010 - nuk ka statistika për 2009.

Në vitin 2017, Qeveria nxori një Udhëzim Administrativ në të cilin ritheksoheshin caqet detyruese për pjesën e përgjithshme të energjisë së ripërtëritshme, si dhe energjinë ripërtëritshme në transport, por duke rritur të ashtuquajturin cak indikativ dhe kapacitetet e rregulluara që do të kërkoheshin për ta përmbushur atë.⁴⁴ Ky cak indikativ ishte vetë zotimi i Kosovës për të shkuar përtej objektivit të rënë dakord në bazë të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Udhëzimi Administrativ përfshinte më shumë kapacitete termike solare dhe një sasi të vogël të furnizimit gjeotermik për sektorët e ngrohjes dhe ftohjes. Sidoqoftë, udhëzimi nuk ofronte detaje të reja se si do të përmbushej caku në sektorin e transportit.

Në sektorin e energjisë elektrike, Udhëzimi rriti kuotën për kapacitetet fotovoltaike solare për 20 MW, por gjithashtu përfshiu edhe më shumë hidrocentrale të vogla se PKVER 2013 - rreth 277 MW kapacitete të reja krahasuar me atë që tashmë ekzistonte më 2009.

Tabela 3: Caqet e Udhëzimit Administrativ 2017 krahasuar me vitin bazë 2009

Burimi i energjisë	2009 MW	2009 GWh	2020 MW	2020 GWh
Hydroenergji	45.84	128.94	593.18	1614
<1 MW	1.76	9.14	288	1216
1 MW-10 MW	9.08	31.9		
>10 MW	35	87.9	305	398
Fotovoltaike solare	0	0	30	61.77
Wind	0	0	150	302.22
Solid biomass	0	0	20	150
Gjithsej	45.84	128.94	793.18	2127.99

Burimi: Udhëzimi Administrativ (MZHE) nr. 05/2017 për Caqet e Burimeve të Energjisë së Ripërtëritshme, PKVER, Kosovë 2013

Përsëri, në vitin 2017, qeveria e atëhershme miratoi Strategjinë e Energjisë e cila kryesisht përqendrohej në ndërtimin e termocentralit të ri me linjit dhe nuk kishte përfshirë shumë elemente të reja për energjinë e ripërtëritshme. Në pjesën më të madhe, strategjia kryesisht kishte përsëritur atë që veçse ishte thënë në vendimet dhe dokumentet e tjera.

Por, ajo kishte përfshirë parashikime për energjinë e ripërtëritshme deri më 2026, por pa përshkruar masa të reja që mund të futeshin për t'i përmbushur ato. Edhe në skenarin e lartë ajo përfshinte vetëm 75 MW fotovoltaike solare dhe binte në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ të përshkruar më sipër që ishte lëshuar në të njëjtin vit, duke përfshirë më pak kapacitet të ri hidroenergjitik - 160 MW, krahas 74 MW tashmë të ndërtuara.⁴⁵

Gjithashtu, në këtë kohë ishte bërë e qartë se planet fillestare për hidrocentralet e Zhurit nuk priteshin të realizoheshin në të ardhmen e afërt meqë ato do të përfshinin ndikime të konsiderueshme ndërkufitare mbi rrjedhën ujore në Shqipëri. Disa centrale ekzistuese në Shqipëri gjithashtu do të ndikonin në sasinë e ujit që do të arrinte në centralet e Zhurit.⁴⁶

⁴⁴ Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Kosovë: *Udhëzimi Administrativ (MZHE) nr. 05/2017 për Caqet e Burimeve të Energjisë së Ripërtëritshme*

⁴⁵ Ministria e Zhvillimit Ekonomik; *Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026, 2017.*

⁴⁶ Mott MacDonald/IPF3: *Strategjia rajonale për hidroenergj të qëndrueshme në Ballkanin Perëndimor, Raport historik nr. 7: Inventari i projekteve të planifikuara të hidrocentraleve, Drafti final 3, Kuadri i Investimeve në Ballkanin Perëndimor, nëntor 2017*

Në vitin 2018, Kosova përditësoi PKVER për ta pasqyruar këtë fakt.⁴⁷ PKVER i ri tregonte se Kosova ishte duke operuar pothuajse siç pritej në drejtim të përmbushjes së elementit të ngrohjes dhe ftohjes të caktuar prej 25 për qind, por ishte shumë larg në zhvillimin e energjisë elektrike të ripërtëritshme. Prandaj, ajo rregulloi ambicjet, duke hequr Zhurin nga planet e energjisë elektrike deri në vitin 2020 dhe duke rritur disi sasinë e fotovoltaikeve solarë dhe të erës që do të ndërtoheshin deri në vitin 2020.

Tabela 4: Planet e sektorit të energji në Kosovë për energjinë e ripërtëritshme krahasuar me vitin bazë 2009, PKVER i dytë, 2018⁴⁸

	2009 MW	2009 GWh	2020 MW	2020 GWh
Hydropower	40	120	167.1	707
<1 MW	0	0	5.6	25
1 MW-10 MW	8	0	111.7	499
>10 MW	32	120	89.8	183
PV	0	0	30	37
Wind	0	0	173.8	350
Total	80	240	519.99	1138.42

Burimi: Kosovë, PKVER 2018, f. 44 dhe 45

The NREAP is aimed at finding a route to compliance with Kosovo's binding target. Unlike in some other countries in the region, it does not set a legal limit on how many power plants can be awarded operating subsidies. Instead, that limit is set by the 2017 Administrative Instruction on renewable energy targets.⁴⁹ Therefore, changing the NREAP to reduce Kosovo's hydropower ambitions did not reduce the number of plants that could be subsidised.

Hidrocentralet e vogla: Kontribut i ulët në energjinë elektrike, por me dëme serioze

Deri në fund të vitit 2019, Kosova kishte në operim më pak se 100 MW hidroenergji, duke përfshirë centralin prej 35 MW, Ujmani. Rreth gjysma e këtij kapaciteti të instaluar përbëhej nga centrale të vjetra jashtë skemës nxitëse, disa prej të cilave ishin rinovuar dhe futur sërish në operim. Kjo do të thotë që gjithsej nëntë centrale që prodhojnë gjithsej 50,02 MW, ishin duke pranuar tarifa nxitëse deri në fund të vitit 2019.⁵⁰

Disa nga centralet e planifikuara dhe tashmë të ndërtuara janë në lokacione të ndjeshme, duke përfshirë në parqe kombëtare, të cilat mendohej se do të mbroheshin me ligj nga aktivitetet që dëmtojnë vlerën e tyre natyrore.

Ndërsa shumë njerëz supozojnë se centralet e vogla kanë vetëm ndikim të vogël, nuk ka qenë rasti i tillë me lumenjtë me vlera ekologjike në Ballkan. Mungesa e planifikimit strategjik dhe legjislativi inekzistent ose joadekuat për sasinë e ujit që do të lihet në rrjedhën e poshtme të pendave nënkuptonte që shtretërit e lumenjve ndonjëherë do të mbesin krejtësisht të thatë.

⁴⁷ Qeveria e Kosovës: [Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Ripërtëritshme të Republikës së Kosovës 2011-2020, përditësuor për 2018-2020, tetor 2018. \(Në dokument shkruan maj 2020, por nga burime të tjera është e qartë se ai u miratua në tetor 2018\).](#)

⁴⁸ Nuk është e qartë pse shifrat e vitit 2009 ndryshojnë nga ato të PKVER fillestare në vitin 2013.

⁴⁹ Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Kosovë: [Udhëzimi Administrativ \(MZHE\) nr. 05/2017 për Cqet e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë](#)

⁵⁰ Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës, [Raporti Vjetor 2019, mars 2020](#)

Këto centrale të vogla janë zakonisht centrale të tipit derivativ, të cilat i fusin lumenjtë dhe përrenjtë në diga dhe pastaj në tuba për të rritur shpejtësinë e ujit dhe efikasitetin e impiantit. Në disa raste, banorët lokalë kanë mbetur pa ujë për ujitje ose për furnizim të bagëtive. Ndërkohë, shpyllëzimi si pasojë e ndërtimit të rrugëve hyrëse dhe tubacioneve ka çuar në erozion dhe shkatërrim të habitateve, ndërsa shtrirja e tubacioneve ka prishur kilometra të tëra të brigjeve të lumenjve.

Impiantet më të diskutueshme në Kosovë janë ato të ndërtuara në lumin Deçan në Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna, nga ndërmarrja austriake Kelkos, filial i kompanisë Kelag.⁵¹

Hidrocentrali në Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna

Hidrocentralet Belaja dhe Deçani, të ndërtuara nga Kelkos, filluan të operojnë më 2016 dhe menjëherë u bënë pjesë e skemës së tarifave nxitëse në Kosovë.⁵² Në të njëjtin vit, KelKos Energy u padit nga Inspektorati i Deçanit, i cili filloi procedurat ligjore kundër kompanisë pasi zbuloi se ishte shkaktuar dëm mjedisor në lumenjtë malorë në zonë. Kompania dyshohet se nuk kishte arritur të siguronte që rrjedha e ujit të lumit të mos binte nën 30 për qind të kapacitetit të plotë të lumit.

Sipas një raporti të Inspektoratit, të siguruar nga BIRN, inspektorët zbuluan se rrjedha e lumit ishte ndërprerë plotësisht përgjatë afro shtatë kilometrave të lumit Lumbardhi, si rezultat i futjes së ujit në tubat e furnizimit të turbinave.⁵³

Fillimisht, Zyra e Rregullatorit të Energjisë kishte lejuar operimin e centraleve, por rasti u ngrit në gjykatë dhe një vendim i përkohshëm i gjykatës, në dhjetor 2020, theksonte që centralet Belaja dhe Deçani duhej të shkyçeshin nga rrjeti. Sidoqoftë, në qershor të vitit 2021, Gjykata e Apelit e ktheu këtë vendim, duke e lejuar Kelkos Energy që të vazhdojë me prodhim të energjisë nga burimet e kufizuara ujore të Kosovës.⁵⁵

Në prill të vitit 2021, Ministri i ri i Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës informoi publikun se do të formonte një grup ndërinstucional punues, i cili do t'i rishikonte procedurat administrative që zbatohen për hidrocentralet ekzistuese dhe ndikimin e tyre në mjedis, si dhe do të mbikëqyrë procesin e aplikimit për marrjen e pëlqimeve ujore, posaçërisht për hidrocentralet.⁵⁶

Duke mos dashur që t'i nënshtrohem të njëjtit fat sikurse banorët në Deçan, komunitetet e tjera në Kosovë, përfshirë Pejë⁵⁷ dhe Shtërpçen,⁵⁸ i rezistuan ndërtuesve të hidrocentraleve - ashtu siç edhe vepruan shumë në pjesën tjetër të Ballkanit.

Në vitin 2019, përpjekjet e banorëve të Shtërpçës për të ndaluar ndërtimin e disa hidrocentraleve nga Grupi Matkos në lumin Lepenc në Malet e Sharrit kapën vëmendjen e gjerë të publikut. Deri në atë moment ndërtimi i projekteve Vica, Shtërpçë dhe Sharri kishte vazhduar që shumë kohë, ndërsa centrali Brezovica tashmë ishte përfunduar. Banorëve lokalë iu ishte ndërprerë furnizimi me ujë nga ndërtimi, duke shkaktuar protesta shtesë.⁶⁰

⁵¹ Riverwatch, [Një tjetër shuplakë në fytyrë për Kelag në Kosovë, 13 dhjetor 2020.](#)

⁵² Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës, [Raporti Vjetor 2019, mars 2020, f. 76.](#)

⁵³ Egzon Dahsyla: [Ministri në largim i mjedisit heq ndalimin e lejeve të hidrocentraleve, Prishtina Insight, 27 shtator 2019.](#)

⁵⁴ Riverwatch, [Një tjetër shuplakë në fytyrë për Kelag në Kosovë, 13 dhjetor 2020.](#)

⁵⁵ Drenushe Ramadani, [Apeli vendos në favor të 'KelKos Energy' për hidrocentralet në Deçan, KALLXO.com, 3 qershor 2021.](#)

⁵⁶ Drenushe Ramadani, [Ministri Aliu paralajmëron shqyrtim të lejeve të hidrocentraleve, KALLXO.com, 24 prill 2021.](#)

⁵⁷ Die Morina dhe Drenushe Ramadani, [Kosova ndalon centralin pas protestës në Pejë, Prishtina Insight, 25 shkurt 2019.](#)

⁵⁸ Prishtina Insight, ['Pa ujë, jeta nuk mund të vazhdojë' thonë protestuesit e hidrocentraleve, 2 korrik 2019.](#)

⁵⁹ Prishtina Insight, ['Pa ujë, jeta nuk mund të vazhdojë' thonë protestuesit e hidrocentraleve, 02 korrik 2019.](#)

⁶⁰ Kosovo Online, [Zbog izgradnje mini hidrocentrale, meštani sela Donja Bitinja ostali bez vode za piće, 3 dhjetor 2019.](#)


Në shkurt të vitit 2019, një komitet ndërinstitucional i mbikëqyrur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës i dha dritën jeshile kompanisë Kelkos për të filluar ndërtimin e më shumë hidrocentraleve në Komunën e Pejës, në lumin Lumbardhi dhe në Parkun Kombëtar Bjeshkët e Nemuna. Kjo shkaktoi rezistencë nga publiku, autoritetet lokale të Pejës, aktivistë mjedisorë dhe anëtarë të tjerë të shoqërisë civile. Deri në fund të muajit, për shkak të intensitetit të protestave, planet u anuluan.⁶²

Rezultatet e kundërta në Pejë dhe Shtërpçë janë pjesërisht rrjedhojë e fazave të ndryshme në të cilat komunitetet lokale erdhën në dijeni për projektet, ku qytetarët në Pejë zbuluan planet me kohë dhe ishin në gjendje të reagonin menjëherë për të parandaluar ndërtimin e tyre. Kjo është relativisht e pazakontë dhe mungesa e konsultimit dhe informacionit publik në lidhje me projekte specifike shpeshherë rezulton në protesta të papritura nga popullata në faza relativisht të vonshme.

Në shkurt të vitit 2021, Avokati i Popullit në Kosovë publikoi rezultatet e një hulumtimi mbi ndërtimet e hidrocentraleve të vogla, i cili theksonte se Ministria e Mjedisit dhe autoritetet lokale nuk kanë arritur të sigurojnë informacion të saktë dhe të plotë nëse hidrocentralet janë duke operuar në përputhje me kërkesat ligjore. Gjithashtu, u konstatua se ministria nuk kishte respektuar parimin e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe rekomandoi publikimin e të gjitha dokumenteve në lidhje me projektet.⁶³

Mbase më së rëndi, duke marrë parasysh të gjitha polemikat dhe shkatërrimin e mjedisit, hidrocentralet e vogla në Kosovë kontribuuan vetëm me 2.3 për qind të prodhimit të energjisë elektrike më 2019⁶⁴

Figure 2: Prodhimi i energjisë elektrike në Kosovë 2019



Burimi: IEA statistikat për 2019

⁶¹ Lumbardhi në Gypa, *Life in Kosovo*, 28 February 2019.

⁶² Die Morina and Drenushe Ramadani, *Kosovo halts power plant after the protest in Peja*, *Prishtina Insight*, 25 February 2019.

⁶³ Kosovo Ombudsman, *Report with recommendations Ex officio 365/2018 Against Ministry of Economy and Environment Regarding the issue of lawfulness of the procedures concerning the hydropower plants in the country as well as access to documents related to hydropower plants*, 3 February 2021.

⁶⁴ Avokati i Popullit në Kosovë, *Annual Report 2019*, March 2020. Calculated from p.78 and p.79 of the English version.


Planet e energjisë së ripërtëritshme nuk janë përmbushur

Në vitin 2017, qeveria miratoi⁶⁵ kuotat për tarifën nxitëse, përfshirë deri në 277.34 MW të prodhuara nga hidrocentralet nën 10 MW. Megjithatë, kuotat u shtrinë vetëm në 150 MW të energjisë së erës dhe 30 MW të kapaciteteve fotovoltaike solare.⁶⁶ PKVER 2018 rriti më tej kapacitetin e planifikuar të centraleve me erë në 173.8 MW deri në vitin 2020.⁶⁷

Në realitet, janë ndërtuar edhe më pak centrale solare dhe të erës - vetëm 10 MW fotovoltaike solare deri në fund të vitit 2019, dhe pak më pak se 34 MW kapacitete me erë,⁶⁸ ndonëse centrali prej 105 MW Bajgora tani ka filluar të ndërtohet.⁶⁹

Për më tepër, përkundër dëmeve, planet e Kosovës për zhvillim të hidrocentraleve janë ende larg realizimit. Tabela më poshtë tregon ndryshimin në mes të kapacitetit të instaluar më 2010, 2019 dhe planin e Kosovës për vitin 2020, siç përshkruhet në PKVER të vitit 2018.

Figure 3: Kapacitetet e instaluar të hidrocentraleve të vogla, PV solare, dhe ato erë në Kosovë, krahasuar me planet për vitin 2020



Burimi: Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Ripërtëritshme 2013,⁷⁰ Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Ripërtëritshme 2018,⁷¹ dhe raporti vjetor i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë 2019.⁷²

Arsyet për këtë dështim për të ndërtuar kapacitetet e planifikuara janë të shumta, por një arsye thelbësore është vëmendja e pamjaftueshme që i kushtohet energjisë së ripërtëritshme nga qeveritë e njëpasnjëshme - veçanërisht në krahasim me kohën, energjinë dhe paratë e shpenzuara për zhvillimin e projektit tashmë të anuluar Kosova e Re, me bazë në thëngjill.⁷³

Tarifat nxitëse kryesisht synojnë energjinë hidrike

Një nga shtytësit kryesorë për zhvillimin e burimeve të ripërtëritshme në shumicën e vendeve në Evropë ka qenë sistemi i "tarifave nxitëse (feed-in)".

Ky sistem mundëson që prodhuesit e energjisë së ripërtëritshme ta shesin të gjithë energjinë elektrike me çmim të përcaktuar paraprakisht, që është më i lartë se çmimi i tregut. Një gjë e tillë ua bën të mundur investitorëve që të ndërtojnë centrale të energjisë ripërtëritshme me siguri të lartë të fluksit të të ardhurave, që do të thotë se investimet janë me rrezik të ulët. Nga ana tjetër, kjo gjithashtu stimulon bankat për të ofruar për ndërtimin e tyre, meqë gjasat për rikthim të kredisë janë shumë të mëdha.

Fillimisht e menduar si mjet për t'i nxitur të gjitha format e energjisë së ripërtëritshme në Kosovë, përfshirë ato solare dhe me erë, sikurse në pjesët e tjera të Ballkanit Perëndimor, ato janë drejtuar në mënyrë joproporcionale drejt hidrocentraleve të vogla.

⁶⁵ Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Kosovë: [Udhëzimi Administrativ \(MZHE\) nr. 05/2017 për Cfaqet e Burimeve të Energjisë së Ripërtëritshme](#)

⁶⁶ Një rritje në kuotën solare për 20 MW u miratua nga Autoriteti Rregullativ i Energjisë më 2019, por në vitin 2020 Komisioni për Ndihmë Shtetërore vendosi që ky vendimi nuk ishte në përputhje me rregullat e BE-së për Ndihmën Shtetërore, rregulla të cilat janë të detyrueshme për Kosovën përmes Traktatit të Komunitetit të Energjisë. Vladimir Spasić, [Tarifat feed-in për termocentralet solare me kapacitet të instaluar prej 20 MW në Kosovë duhet të ndalen](#), [Balkan Green Energy News](#), 2 dhjetor 2020

⁶⁷ Qeveria e Kosovës: [Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Ripërtëritshme të Republikës së Kosovës 2011-2020, përditësuar për 2018-2020, tetor 2018, f. 44](#).

⁶⁸ Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës, [Raporti Vjetor 2019, mars 2020](#).

⁶⁹ Energjia e Kosovës, [Në Bajgorë është bërë vendosja e turbinës së parë për prodhimin e rrymës, 17 maj 2021](#).

⁷⁰ Qeveria e Kosovës: [Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Ripërtëritshme, 2013](#).

⁷¹ Qeveria e Kosovës: [Plani Kombëtar i Veprimit për Energjinë e Ripërtëritshme të Republikës së Kosovës 2011-2020, përditësuar për 2018-2020, tetor 2018](#).

⁷² Zyra e Rregullatorit të Energjisë së Kosovës, [Raporti Vjetor 2019, mars 2020](#). Llogaritur nga f. 78 dhe f. 79 të versionit në anglisht.

⁷³ Pippa Gallop, [ContourGlobal më në fund largohet nga centrali i thëngjillit Kosova e Re, Rrjeti CEE Bankwatch, 17 mars 2020](#).

Tarifat nxitëse në Kosovë

Sistemi i tarifave nxitëse është përdorur përgjithësisht në BE, por tani po hiqet gradualisht për centralet më të mëdha se 500 kW, me vendosjen gjithnjë e më të madhe të energjisë së ripërtëritshme. Që nga dhjetori i vitit 2020, Autoriteti Rregullativ i Energjisë së Kosovës (ZRRE) nuk lëshon më tarifa të reja nxitëse për centralet që nuk kanë marrë Autorizim Paraprake ose Përfundimtar dhe që futeshin në kuotat e përcaktuara për sasinë e kapacitetit që do të mund të pranoheshin. ⁷⁴ Megjithatë, meqë projektet që tashmë ishin pranuar në sistemin e stimujve do të vazhdojnë të pranojnë tarifa nxitëse, koncepti shpjegohet si në vijim.

Deri në vendimin e ZRRE-së në dhjetor 2020, prodhuesi që planifikonte të prodhonte energji të ripërtëritshme e që aplikonte në ZRRE për autorizim për të ndërtuar një strukturë të energjisë së ripërtëritshme, lejohej që të kërkonte edhe pranim në skemën e mbështetjes. Së pari lëshohej një Autorizim i Përkohshëm për ndërtim, dhe kjo siguronte të drejtën për të marrë më vonë një tarifë nxitëse, për sa kohë sa centrali ishte i vendosur brenda kuotës për secilën teknologji. Por, e drejta për të ndërtuar centralin jepet vetëm përmes Autorizimit Përfundimtar.

Pasi KOSTT-i, si Operator i Tregut, të ketë përgatitur marrëveshjen e blerjes së energjisë me operatorin e centralit, KOSTT-i, si Operator i Sistemit të Transmisionit, ose KEDS, si Operator i Sistemit të Shpërndarjes, është i detyruar ligjërisht ta blejë sasinë e dakorduar të energjisë elektrike nga prodhuesit e privilegjuar me çmim stimulues për një periudhë fikse prej 10-12 vite, në varësi të teknologjisë. ⁷⁵

Një sistem i tillë mund të zbatohet vetëm për një sasi të kufizuar të kapacitetit të energjisë së ripërtëritshme, përndryshe shkakton kosto të larta për konsumatorët. Prandaj, Kosova ka vendosur kufizime në sasinë e kapacitetit të ri që mund të marrë tarifa nxitëse. Por, ajo nuk i ka trajtuar në mënyrë të barabartë burimet e ndryshme të energjisë. Kapacitetet me erë dhe ato solare kishin kuota të ulëta të sasisë së kapacitetit që mund të përfitonte tarifa nxitëse, ndërsa hidrocentralet e vegjël kishin kuota shumë të larta. ⁷⁶

Përkundër prodhimit të vetëm 2.8 për qind të energjisë elektrike të prodhuar në Kosovë më 2018, (154 GWh) nga 5,437 GWh ⁷⁷) hidrocentralet, me kapacitet më të vogël se 10 MW, morën 6.5 milionë euro ⁷⁸ nga gjithsej 9 milionë euro të paguara përmes tarifave nxitëse. Me fjalë të tjera, hidrocentralet morën 72.6 për qind të tarifave nxitëse.

Solar photovoltaics received 0.2 million euros and wind 2.2 million euros, after the Kitka wind farm came online in the latter part of the year (Air Energy in the Table below) ⁷⁹. Both of these generated less than 1 percent of Kosovo's domestically generated energy in 2018. ⁸⁰

Kostot për stimujt e energjisë së ripërtëritshme duket se janë rritur në 15.7 milionë euro më 2019 ⁸¹ dhe në 18.6 milionë euro më 2020 ⁸². Sidoqoftë, për aq sa kemi njohuri, nuk ka zberthime të disponueshme për këto vite. Pritet që pjesa e stimujve për erën të rritet për shkak të fermës me erë Kitka që futet në operim në fund të vitit 2018.

As sektori solar nuk ka qenë imun nga çështjet e korrupsionit, siç tregon një hulumtim i Prishtina Insight në qershor 2020. Ndërsa rregullat në Kosovë përcaktojnë që asnjë investitor i vetëm nuk mund të prodhojë më shumë se tre megavat energji solare, u zbulua se një njeri - Blerim Devolli - qëndron pas gjashtë kompanive të cilave u janë dhënë të drejtat e prodhimit prej gjithsej 16.7 MW. ⁸³

⁷⁴ Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Kosovë, [Vendimi V.1321.2020.10 dhjetor 2020](#)

⁷⁵ Rregulla e ZRRE-së Nr. 10/2017, [Rregulla për skemën e mbështetjes për prodhuesit e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, 27 prill, 2017](#)

⁷⁶ Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Kosovë: [Udhëzimi Administrativ \(MZHE\) nr. 05/2017 për Çaqet e Burimeve të Energjisë së Ripërtëritshme](#)

⁷⁷ Qeveria e Kosovës: [Zyra e Kryeministrit dhe Agjencia e Statistikave: Bilanci vjetor i energjisë për vitin 2018, 2019.](#)

⁷⁸ KOSTT: [Përgjigja në kërkesën për informacion, 30 gusht 2019.](#)

⁷⁹ KOSTT: [Përgjigja në kërkesën për informacion, 30 gusht 2019.](#)

⁸⁰ Qeveria e Kosovës, [Zyra e Kryeministrit dhe Agjencia e Statistikave: Bilanci vjetor i energjisë për vitin 2018, 2019.](#)

⁸¹ Grant Thornton, [Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur, Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut - KOSTT Sh.A., f. 28, 31 dhjetor 2019.](#)

⁸² RSM Kosovo, [Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur, Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut - KOSTT Sh.A., f. 31, 31 dhjetor 2020.](#)

⁸³ [Visar Prebreza dhe Jeta Xharrja, Energjia e papastër: Kosovari që do të zotëronte diellin, Prishtina Insight, 2 qershor 2020.](#)

Në vitin 2019, Zyra e Rregullatorit të Energjisë miratoi një tarifë nxitëse prej 20 MW shtesë për kapacitete fotovoltaike solare, në përputhje me Udhëzimin Administrativ të vitit 2017 të përshkruar më lart⁸⁴. Sidoqoftë, më 24 nëntor 2020, mbase i ndikuar nga polemikat e gjeneruara nga artikulli i Prishtina Insight, si dhe pas presionit të vazhdueshëm nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, Komisioni i Ndhmës Shtetërore të Kosovës nxori vendimin e tij të parë në lidhje me ndihmën shtetërore në sektorin e energjisë.

Në vendim u konstatua se tarifa nxitëse e caktuar në mënyrë administrative për 20 MW të projekteve fotovoltaike nuk ishte në përputhje me legjislacionin evropian për ndihmën shtetërore, sepse nuk ishte njoftuar tek autoriteti kompetent i ndihmës shtetërore para se të jepej dhe nuk është në përputhje me udhëzimet e BE-së mbi ndihmën shtetërore për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë.⁸⁵

Mësimet e nxjerra nga planifikimi i energjisë së ripërtëritshme të Kosovës deri në vitin 2020 janë përmbledhur në seksionin e Rekomandimeve.

Perspektiva e vitit 2030 - çfarë pritet nga Kosova?

Direktiva e Energjisë së Ripërtëritshme II,⁸⁷ Caqet për 2030 dhe Planet Kombëtare të Energjisë dhe Klimës

Në dhjetor 2018, në BE hyri në fuqi Direktiva e re e Energjisë së Ripërtëritshme, e cila vazhdon të përdorë përkufizimin e energjisë së ripërtëritshme të vendosur në 2009. Ajo përkufizon 'energjinë nga burimet e ripërtëritshme' si "energji nga burimet e ripërtëritshme jofosile, përkatësisht energjia e erës, diellit, aerotermike, gjeotermike, hidrotermike dhe oqeanike, hidrocentralet, biomasa, gazi i deponive, gazi i impianteve të trajtimit të ujërave të zeza, dhe biogazërat".

Direktiva përmban një cak të përgjithshëm të energjisë së ripërtëritshme prej 32 për qind të konsumit bruto të energjisë përfundimtare deri më 2030. Shtetet Anëtare të BE-së duhet t'i përcaktojnë kontributet kombëtare për të përmbushur, në mënyrë kolektive, cakun e përgjithshëm detyruar të Bashkimit si pjesë e dokumenteve që quhen plane të integruara kombëtare të energjisë dhe klimës (PKEK).

E ashtuquajtura Rregullore e Qeverisjes së BE-së⁸⁸ përcakton kërkesat për plane të tilla. Ato bashkojnë caqet e reduktimeve të emetimeve të gazrave serrë, caqet e energjisë së ripërtëritshme dhe caqet e efijencës së energjisë, si dhe do të hartohen për periudha dhjetëvjeçare, me PKEK-të e para që do mbulojnë periudhën 2021-2030. Kjo do të thotë se nuk ka më detyrim për të miratuar Plane Kombëtare të Veprimit për Energji të Ripërtëritshme.

Por, Komisioni Evropian tani ka propozuar rritje cakt për ulje të gazit serrë të BE në 55 për qind, krahasuar me nivelet e vitit 1990, nga caku aktual prej 40 për qind.⁸⁹ Për ta arritur këtë cak, do të duhet të ngrihet edhe caku i energjisë së ripërtëritshme për vitin 2030. Nuk ka drafte në dispozicion publik, por raportet e mediave sugjerojnë që Komisioni do të propozojë një cak prej 38-40 për qind të energjisë së ripërtëritshme deri më 2030.⁹⁰

⁸⁴ Zyra e Rregullatorit të Energjisë, [Vendim për përcaktimin e tarifës nxitëse \(Feed in\) për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike, vetëm për caqet shtesë prej 20 MW sipas Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për Caqet e Burimeve të Energjisë Elektrike](#), 27 nëntor 2019

⁸⁵ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, [Autoriteti i ndihmës shtetërore në Kosovë merr vendimin e parë në lidhje me mbështetjen e papajtueshme të shtetit për burimet e ripërtëritshme](#), 26 nëntor 2020.

⁸⁶ Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Kosovë, [Vendimi V. 1321. 2020. 10 dhjetor 2020](#).

⁸⁷ [Direktiva \(BE\) 2018/2001 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 dhjetorit 2018 mbi promovimin e përdorimit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme](#).

⁸⁸ [Rregullorja \(BE\) 2018/1999 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e 11 dhjetorit 2018 mbi Qeverisjen e Unionit të Energjisë dhe Veprimit Klimatik, që ndryshon Rregulloret \(KE\) Nr. 663/2009 dhe \(KE\) Nr. 715/2009 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, Direktivat 94/22/KE, 98/70/KE, 2009/31/KE, 2009/73/KE, 2010/31/BE, 2012/27/BE dhe 2013/30/BE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, Direktivat e Këshillit 2009/119/EC dhe \(BE\) 2015/652 dhe shfuqizon Rregulloren \(BE\) Nr. 525/2013 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit](#).

⁸⁹ Komisioni Evropian, [korniza e klimës dhe energjisë 2030, qasur së fundmi më 27 maj 2021](#).

⁹⁰ [Frédéric Simon, Leak:Projektligji i BE-së për burimet e ripërtëritshme konfirmon cakun prej 38-40% për 2030, Euractiv, 4 maj 2021](#).

Diskutimet brenda Komunitetit të Energjisë janë aktualisht duke u zhvilluar për të vendosur caqet e vitit 2030. Një studim i kryer nga konsorciumi E3M është duke vazhduar që nga maji 2021 dhe pritet të paraqesë skenarin bazë si dhe metodologjinë për përcaktimin e caqeve që do të paraqitet në korrik 2021 në takimin jozyrtar të Këshillit Ministror të Komunitetit të Energjisë. Nëse gjithçka shkon mirë, caqet do të miratohen në takimin e Këshillit Ministror të nëntorit 2021.⁹¹

Zhvillimi i caqeve për 2030 dhe PKEK-ve janë hapa të domosdoshëm për të siguruar vazhdim e tranzicionit nga karburantet fosile drejt një shoqërie të bazuar në burime të ripërtëritshme me efikasitet energjetike, por sikurse me caqet e vitit 2020, ende ka rrezik që do të përfitojnë hidrocentralet dhe teknologjitë e tjera të paqëndrueshme të ripërtëritshme. U takon qeverive, ekspertëve dhe shoqërisë civile që të sigurojnë se kjo nuk ndodh.

Skemat e stimujve të energjisë së ripërtëritshme deri në vitin 2030

Janë tre dokumente kryesore që përcaktojnë rregullat e BE-së mbi stimujt e energjisë së ripërtëritshme:

- Direktiva e Energjisë së Ripërtëritshme II
- Të ashtuquajturat Udhëzime të Ndhmës Shtetërore për Energji dhe Mjedis 2014-2020 (EEAG)⁹²
- E ashtuquajtura Rregullore e Përgjithshme e Përrjashtimit të Bllokut.⁹³

Të gjitha këto janë aktualisht në proces të rishikimit,⁹⁴ ndërsa dy të fundit planifikohet të finalizohen më 2021 dhe vetëm Direktiva e re e Energjisë së Ripërtëritshme të finalizohet më vonë. Për këtë arsye, Kosova do të duhet të përcjellë me shumë kujdes se çfarë po ndodh në nivel të BE-së dhe të jetë e gatshme për t'u përshtatur.

Sidoqoftë, tani për tani mjafton të jenë në pajtueshmëri me versionet aktuale të këtyre dokumenteve, të gjitha prej të cilave kanë qasje të ngjashme për nxitje të investimeve në energji të ripërtëritshme dhe kufizojnë tarifat nxitëse vetëm për centralet më të vogla. EEAG ofron më së shumti detaje, prandaj është përshkruar përshkruhet më gjerësisht më poshtë.

Udhëzimet për Ndhmën Shtetërore për Energji dhe Mjedis 2014-2020 (EEAG)⁹⁵

Në vitin 2014, Drejtoria e Përgjithshme e BE-së për Konkurrencën nxori rregullat e përditësuara për nxitjen e burimeve të ripërtëritshme në Udhëzimin e Ndhmës Shtetërore për Energji dhe Mjedis 2014-2020 (EEAG), me risi të konsiderueshme krahasuar me Direktivën e Energjisë së Ripërtëritshme 2009, duke siguruar që investitorët e burimeve të ripërtëritshme ekspozohen së paku ndaj disa rreziqeve të tregut. Edhe pse quhet "Udhëzim", ky dokument është i detyrueshëm, megjithëse Shtetet Anëtare të BE-së mund ta kundërshtojnë atë në Gjykatën Evropiane të Drejtësisë nëse konsiderojnë se është në kundërshtim me Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian.

EEAG kërkon një qasje më të bazuar në treg për të marrë mbështetje për energji të ripërtëritshme, për të arritur një ekuilibër më të mirë midis ofrimit të mbështetjes duke shmangur kostot e tepërta për publikun. Vendet e Komunitetit të Energjisë duhet t'i aplikojnë këto rregulla, por progresi ka qenë i fragmentuar.⁹⁶

⁹¹ Komuniteti i Energjisë, [Procesverbali i Takimit të Grupit të 6-të Teknik për Energji Klimë, 23 shkurt 2021](#).

⁹² Komisioni Evropian, [Komunikim nga Komisioni - Udhëzime për ndihmën shtetërore për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë 2014-2020, vizituar së fundmi më 27 maj 2021](#).

⁹³ [Rregullorja e Komisionit \(BE\) Nr. 651/2014 e datës 17 qershor 2014 që shpall disa kategori të ndihmave në përputhje me tregun e brendshëm në zbatim të neneve 107 dhe 108 të Traktatit, vizituar për herë të fundit më 27 maj 2021](#).

⁹⁴ See European Commission, [-State aid for environmental protection and energy revised guidelines, public consultation, -State subsidies exemptions to approval requirement for the Green Deal and EU industrial and digital Strategies, EU renewable energy rules - review, all last accessed 27 May 2021](#).

⁹⁵ Komisioni Evropian, [Komunikim nga Komisioni - Udhëzime për ndihmën shtetërore për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë 2014-2020, hyrë për herë të fundit më 27 maj 2021](#).

⁹⁶ CEE Bankwatch Network, [Stimujt e energjisë së ripërtëritshme në Ballkanin Perëndimor, janar 2021](#).

Neni 18 i Traktatit të Komunitetit të Energjisë përcakton që: “Do të jenë të papajtueshme me funksionimin e duhur të këtij Traktati, të gjitha pikat e mëposhtme, për sa kohë që mund të prekin tregtinë e Energjisë së Rrjetit ndërmjet Palëve Kontraktuese:

... (c) çdo ndihmë publike e cila shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke favorizuar disa sipërmarrje ose burime të caktuara të energjisë.

2. Çdo praktikë që bie në kundërshtim me këtë nen do të vlerësohet në bazë të kriterëve që dalin nga zbatimi i rregullave të Neneve 81, 82 dhe 87 të Traktatit, për krijimin e Komunitetit Europian (bashkëngjitur në Shtojcën III

Çdo ndryshim në legjislacionin për stimujt e ripërtëritshëm do të zbatohet për projektet e reja, por jo për marrëveshjet tashmë të nënshkuara me investitorët para se të hynin në fuqi. Qëllimi është që përfundimisht të heqim dorë nga shumica e subvencioneve të energjisë së ripërtëritshme pasi burimet e ripërtëritshme bëhen gjithnjë e më konkurruese në kuptim të kostove.

Mund të argumentohet se hidrocentralet në disa raste veçse janë me kosto konkurruese, por meqë logjika e rregullave të BE-së për ndihmën shtetërore bazohet në përmbushjen e caqeve me neutralitet ndaj teknologjisë, ka pak gjasë që BE-ja të lëvizë drejt parandalimit të subvencioneve për disa burime para të tjerëve. Sidoqoftë, janë disa kriterë të qëndrueshmërisë mjedisore tashmë të vendosura, siç është kërkesa që energjia hidrike të jetë në përputhje me Direktivën Kornizë për Ujin dhe legjislacionin tjetër mjedisor të BE-së.

Karakteristikat kryesore të reja në EEAG në lidhje me stimujt e energjisë së ripërtëritshme janë:

- Që nga 1 janari 2017, në BE subvencionet duhet të jepen në bazë të instrumenteve të tregut, siç janë ankandet ose proceset konkurruese të tenderëve të hapur për të gjithë prodhuesit e energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme;
- Tenderët për teknologji specifike lejohen në bazë të potencialit afatgjatë të një teknologjie, nevojës për të arritur diversifikim, kufizimeve të rrjetit dhe stabilitetit të rrjetit, si dhe kostove të integritit të sistemit. Përgjithësisht bëjnë instalimet me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike më pak se 1 MW ose projektet demonstruese, përveç energjisë elektrike nga era, ku nuk zbatohet për instalime me kapacitet të instaluar deri në 6 MW, ose 6 njësi prodhimi. Për këto njësi më të vogla ankande nuk janë të nevojshme;
- Që nga 1 janari 2016, të gjitha skemat dhe masat e reja të ndihmës është dashur ta kenë ndihmën si prim shtesë krahas çmimit të tregut. Pra, në vend që ta mbulojë tërë çmimin e blerjes së energjisë elektrike me ndihmë shtetërore, ndihma shtetërore vetëm mund ta plotësojë çmimin e tregut duke paguar një prim (shih Figurën 4) . Kjo do të duhej t'i ulte kostot për konsumatorët fundorë. Përgjithësisht bëjnë instalimet me kapacitet të instaluar të energjisë elektrike më pak se 500 kW ose projektet demonstruese, përveç energjisë elektrike nga era, ku aplikohet kapaciteti për energji të instaluar elektrike deri në 3 MW, ose 3 njësi prodhimi. Për këto ende lejohen tarifatat nxitëse.

Figura 4: Modeli i tarifave nxitëse kundrejt modelit me prime rrëshqitëse nxitëse⁹⁷



Burimi: Përshtatur nga Banja M. et al: Burimet e ripërtëritshme në BE: korniza mbështetëse drejt tregut të përbashkët të energjisë

Për të funksionuar sistemet e primeve rrëshqitëse, nevojitet një treg funksional një-ditë-para i energjisë elektrike për të ditur çmimin e tregut dhe me këtë edhe shumën e primit që duhet paguar për ta plotësuar atë në sipas dakordimit.

Prandaj, prodhuesit do të zotohen për një çmim të prodhimit të cilin ata mendojnë se mund ta arrijnë dhe atyre që ofrojnë çmimin më të ulët do t'u jepet e drejta për të nënshkruar kontratë për tarifa nxitëse, nëse arrijnë ta ndërtojnë centralin.

Këto, sikurse tarifatat nxitëse, mund të çojnë në kosto të larta për konsumatorët nëse nuk përdoren me masë. Por përparësia e sistemit të ri është se investitorët duhet të analizojnë nga afër investimet e tyre paraprakisht - nëse ata ofrojnë çmim shumë të lartë, ata nuk do të fitojnë në ankand, dhe nëse ofrojnë çmim shumë të ulët, ata nuk do të jenë në gjendje që vërtetë të prodhojnë në atë çmim dhe do të humbin para.

Dizajnimi i ankandëve të tilla me rregulla të duhura është çështje e ndërlikuar dhe nuk është qëllimi i këtij raporti të hyjë në të gjitha detajet. Ajo që ka rëndësi për përmirësimin e qëndrueshmërisë mjedisore dhe pranimin publik të energjisë së ripërtëritshme në Kosovë është kryesisht se cilat teknologji do të mund të kualifikohen, nëse do të vendosen kritere mjedisore siç janë zonat e ndaluara, dhe nëse ankandet do të përfshijnë forma të paqëndrueshme të energjisë.

⁹⁷ Banja M., Jégard M., Monforti-Ferrario F., Dallemand J.-F., Taylor N., Motola V., Sikkema R., *Burimet e ripërtëritshme në BE: kuadri mbështetës drejt një tregu të përbashkët të energjisë - raportimi i shteteve të BE-së në kuadër të nenit 22(1) b, e dhe f të Direktivës së Energjisë së Ripërtëritshme, EUR 29100EN, Zyra e Publikimit e Bashkimit Evropian, Luxemburg, 2017.*

⁹⁸ Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, në bashkëpunim me Agjencinë Ndërkombëtare të Energjisë së Ripërtëritshme: *Përzgjedhja dhe Mbështetja Konkurruese për Udhëzimet e Politikave të Energjisë së Ripërtëritshme, mars 2018.*

Nevojiten ndryshime legislative

Deri në qershor të vitit 2021, legjislacioni i Kosovës është shumë i bazuar në përmbushjes e caqeve të vitit 2020 dhe ende nuk janë përcaktuar caqet për 2030. Direktiva e Energjisë së Ripërtërishme 2018 nuk është transpozuar, dhe të gjitha referencat në stimuj për energji të ripërtërishme kanë të bëjnë me tarifatat nxitëse e jo me ankandet dhe primet.

Ende mungon legjislacioni që u mundëson ekonomive familjare të bëhen prosumues (që prodhojnë energji elektrike të tyre dhe ushqejnë tepicën në rrjet) dhe duhet të miratohet sa më shpejt, ndërsa mungojnë edhe kriteret e qëndrueshmërisë për biomasë dhe biokarburante.

Gjithashtu, i kemi identifikuar disa çështje të tjera në legjislacion që duhet të adresohen.

Ligji për Energjinë⁹⁹

Ligji për Energjinë përcakton kornizën e përgjithshme për promovimin e energjisë së ripërtërishme dhe gjithashtu përshkruan procesin për zhvillimin e strategjisë kombëtare të energjisë dhe PKVER. Ai përfshin një referencë për ofrimin e stimujve, por jep detaje të tjera. Duke marrë parasysh që PKVER mund të mos jetë më i nevojshëm pas vitit 2020, ligji me shumë gjasë do të duhet të ndryshohet.

Në çdo rast, ekziston një veçori problematike e këtij ligji në lidhje me burimet e ripërtërishme - përkufizimi i dhënë në nenin 3:

“1.5. Burimet e Ripërtërishme të Energjisë - burime të ripërtërishme jofosile të energjisë siç janë: energjia nga era, energjia diellore, ujërat gjeotermale, energjia e valëve, energjia e ujit, biomasa, gazi i deponive të mbeturinave, gazi nga trajtimi i ujërave të zeza, bogazi si dhe çdo teknologji që prodhon energji elektrike dhe e ka certifikatën e institucioneve garantuese për këtë teknologji”.

Pjesa e fundit e këtij përkufizimi devijon nga Direktiva e BE-së për Energjinë e Ripërtërishme (shih më lart). Fushëveprimi i përkufizimit të Kosovës është shumë i gjerë dhe rrezikon të lejojë që format jo të ripërtërishme të energjisë, si gazi, thëngjilli ose hidrogjeni të përfshihen në skemat nxitëse. Ky përkufizim duhet të ndryshohet.

Ligji për Energjinë Elektrike¹⁰⁰

Ligji për Energjinë Elektrike në terma shumë të përgjithshëm paraqet konceptin e tarifave nxitëse për energjinë e ripërtërishme. Ai paraqet konceptin e Prodhuesit të Kualifikuar (pra, një prodhues që mund të pranojë stimuj) në nenin 3:

“1.78. Prodhues i Kualifikuar - një ndërmarrje e energjisë dhe / ose personi tjetër juridik apo fizik që prodhon energji nga burime të ripërtërishme ose njëkohësisht prodhon energji elektrike dhe energji termike në një mënyrë shumë efikase, në një impiant të veçantë prodhues duke përdor mbeturina apo burime të ripërtërishme të energjisë në një mënyrë ekonomike të qëndrueshme në përputhje me mbrojtjen e mjedisit.”

Përkufizimi i burimeve të ripërtërishme në këtë ligj është në përputhje me përkufizimin e BE-së, ndryshe nga Ligji për Energjinë, por fraza “përdor mbeturina ose burime të ripërtërishme të energjisë” ngre shqetësim. Në BE, lejohen stimujt për kogjenerim shumë efikas dhe kjo është menduar të përfshijë edhe centralet e djegies së mbeturinave (përfshirë mbetjet jo-organike) që prodhojnë ngrohje dhe energji elektrike, nëse ato cilësohen si shumë efikase.

Sidoqoftë, EEAG bën të qartë se kjo vlen vetëm nëse respektohet hierarkia e mbeturinave, e cila, duke marrë parasysh mungesën e parandalimit dhe riciklimit të mbeturinave, vështirë se do të jetë e mundur në Kosovë.

⁹⁹ [Ligji për energji, nr. 05/L-081, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 24, 13 korrik 2016.](#)

¹⁰⁰ [Ligji për Energjinë Elektrike nr. 05/L-085, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 26, 21 korrik 2016](#)

Për më tepër, formulimi këtu nuk përcakton respektimin e formulës së BE-së të paraqitur në Aneksin II të Direktivës së Eficiencës së Energjisë¹⁰¹ në vendosjen nëse një central kualifikohet si me efikasitet të lartë. Përfundimisht, ajo nuk kufizon mbështetjen për centralet e kombinuara të nxehtësisë ngrohjes dhe energjisë me bazë në mbeturina, por potencialisht lejon mbështetjen për centralet që prodhojnë vetëm energji elektrike, ose vetëm ngrohje nga mbeturinat, duke përfshirë mbeturinat jo-organike, në kundërshtim me legjislacionin e BE-së. Prandaj, ky nen duhet të ndryshohet.

Neni 8.5. i Ligjit për Energjinë Elektrike përcakton që Operatori i Sistemit të Transmisionit (OST) ose Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), në përputhje me kërkesat për besueshmëri dhe siguri operacionale, duhet ta blejë tërë energjinë elektrike të prodhuar nga prodhuesit e kualifikuar të energjisë elektrike, në përputhje me rregulloret, posaçërisht Kodin e Rrjetit të Transmisionit dhe Kodin e Rrjetit të Shpërndarjes.

Neni 23 gjithashtu specifikon që Operatori i Tregut është përgjegjës për: “përmbylljen e marrëveshjes për shitblerjen e pjesës së obligueshme të energjisë elektrike të prodhuar nga energjia e burimeve të ripërtëritshme dhe bashkëprodhimi”

Për të kaluar në sistem me ankande dhe prime nxitëse të furnizimit, kjo do të duhet të ndryshohet, sepse nuk do të jetë më e detyrueshme për OST ose OSSH të blejë të gjithë energjinë elektrike nga të gjithë Prodhuesit e Kualifikuar, përveç potencialisht për ata më të vegjlit (nën 500 kW në shumicën e rasteve). Në vend të kësaj, energjia elektrike do të shitej në tregun e hapur, ku vetëm një prim do të paguhet për prodhuesin për të kompensuar çdo ndryshim midis çmimit të tregut dhe çmimit që prodhuesi ishte zotuar të prodhonte energjinë gjatë procesit të ofertimit.

Legjislacioni zbatues i cili është vjetruar

Disa pjesë të legjislacionit zbatues tashmë janë vjetruar me skadimin e periudhës së synuar 2020. Këto përfshijnë:

- Udhëzimi Administrativ nr. 05/2017 për Caqet e Burimeve të Energjisë së Ripërtëritshme,¹⁰²
- Rregulla nr. 10/2017 e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) për skemën e mbështetjes për prodhuesit e burimeve të ripërtëritshme të energjisë¹⁰³ dhe
- Vendimi i ZRRE-së V_810_2016 për përcaktimin e tarifave nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë¹⁰⁴

Udhëzimi Administrativ ishte dokumenti kryesor që përcaktonte kapacitetin total të energjisë së ripërtëritshme që mund të merrte tarifa nxitëse¹⁰⁵ në mënyrë që të kontribuojë në synimin e Kosovës për vitin 2020.

Ndërkohë, Rregulla nr. 10/2017 përcakton më shumë detaje mbi skemën e tarifave nxitëse. Ai do të duhet të rishkruhet ose zëvendësohet plotësisht në mënyrë që t'i përshtatet një skeme mbështetjeje të bazuar kryesisht në ankande dhe prime.

Procesi për përcaktimin e tarifave për skemën e mbështetjes përshkruhet në nenin 9, i cili përmend edhe tarifën nxitëse edhe primet nxitëse. Sidoqoftë, meqenëse asnjë ligj nuk kërkon që ankandet të konkurrojnë për këto prime, dhe pasi nuk përcaktohet asnjë parametër për sasinë e kapacitetit për të përfituar prime, apo prag të madhësisë së centralit, kjo nuk mund të konsiderohet e mjaftueshme për qenë në përputhje me EEAG.

Vendimi i ZRRE-së V_810_2016 rregulloi nivelin e tarifave nxitëse në marrëveshjet e reja të blerjes së energjisë. Gjithashtu, aty përmendet madhësia maksimale e centraleve që mund të marrin tarifa nxitëse dhe në çfarë niveli mund të subvencionohen teknologjitë gjithsej, por këto dispozita tashmë ishin të vjetruara në vitin 2017, kur u nxor Udhëzimi Administrativ i cekur më sipër.

Sapo Kosova të kalojë në ankande dhe prime, nëse dëshiron, ajo mund t'i mbajë tarifën nxitëse vetëm për centralet nën 500 kW, me përjashtim për erën (shih EEAG). Sidoqoftë, tarifën aktuale nga viti 2016 janë të vjetruara dhe duhet të përditësohen, andaj edhe Vendimi duhet të rishkruhet në tërësi.

¹⁰¹ Direktiva 2012/27/BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 tetorit 2012 mbi eficiencën e energjisë, që ndryshon Direktivat 2009/125/KE dhe 2010/30/BE dhe shfuqizon Direktivat 2004/8/KE dhe 2006/32/KE, ndryshuar me Direktivë të Këshillit 2013/12/BE datë 13 maj 2013, Direktiva (BE) 2018/844 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 30 majit 2018, Direktiva (BE) 2018/2002 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 dhjetorit 2018, Rregullorja (BE) 2018/1999 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 11 Dhjetorit 2018 dhe Rregullorja e Deleguar e Komisionit (BE) 2019/826 e 4 Marsit 2019. Versioni i konsoliduar i disponueshëm në: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:02012L0027-20190612&from=EN>

¹⁰² Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Kosovë: Udhëzimi Administrativ (MZHE) nr. 05/2017 për Caqet e Burimeve të Energjisë së Ripërtëritshme

¹⁰³ Rregulla e ZRRE-së Nr. 10/2017, Rregulla për skemën e mbështetjes për prodhuesit e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, 27 prill, 2017

¹⁰⁴ Vendimi i ZRRE-së V_810_2016 për përcaktimin e tarifave nxitëse për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë, 19 maj 2016

¹⁰⁵ Sipas nenit 6 të Rregullit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë 2017 mbi Skemën Mbështetëse për Prodhuesit e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë.

Lëvizjet e deritanishme drejt ndryshimeve në sistemin e masave nxitëse në Kosovës

Në sistemin e masave nxitëse në Kosovë nevojiten ndryshime, edhe për të qenë në përputhje me zotimet e Ndhmës Shtetërore të Komunitetit të Energjisë edhe për të siguruar që kostot e mbështetjes për energjinë e ripërtëritshme të mos bëhen shumë të larta ose të vazhdojnë të mbështesin teknologjitë e dëmshme.

Ndryshime të tilla do të zbatoheshin për termocentralet e reja që nuk kanë aplikuar tashmë për miratim paraprak në kohën kur është miratuar legjislacioni i ri. Për centralet ekzistuese dhe ato që kanë filluar procedurat për të përfituar nga masat nxitëse, pajtueshmëria e tyre do të duhet të vlerësohet një nga një.

Në nëntor të vitit 2017, Ministri i atëhershëm i Kosovës për Zhvillim Ekonomik, Valdrin Lluka, zbuloi planet për të zhvilluar një skemë ankandi në Kosovë që do të ndihmonte në rritjen e investimeve në prodhimin solar.¹⁰⁶

Nuk ishte shënuar progres i ndjeshëm deri në shtator 2019 kur BERZH njoftoi se po kërkonte konsulencë për forcimin e kuadrit ligjor dhe rregullativ për ankandet e energjisë së ripërtëritshme; zhvillimin e tërë dokumentacionit të ankandit që nevojitet për ankande fotovoltaike solare dhe ankande të erës; si dhe për tu siguruar autoriteteve ndihmë të detajuar teknike, financiare dhe ligjore për zbatimin e një raundi të ankandëve; dhe zhvillimin e kornizës për skemën e ardhshme konkurruese të prokurimit.¹⁰⁷

Në nëntor të vitit 2019, IFC gjithashtu njoftoi se do të vazhdojë të jetë këshilltar kryesor i transaksionit në Qeverinë e Kosovës për të prokuruar zhvillimin, ndërtimin dhe operimin e mirëmbajtjen e 50 MW të energjisë fotovoltaike solare.¹⁰⁸

Ajo që kemi parë në Maqedoninë e Veriut është që Qeveria aplikoi ankande dhe prime për kapacitetet solare të dhe erës, por la paprekur tarifën nxitëse për hidrocentralet. Kjo i jep hidrocentraleve avantazh në treg dhe çështja është aktualisht në nivel të ankesës në Komunitetin e Energjisë nga Eko-svest dhe Bankwatch. Një skenar i tillë duhet të shmanget në Kosovë, e cila tashmë ka ndërmarrë hapin e parë me anulimin e sistemit të tarifave nxitëse në dhjetor 2020.¹⁰⁹

Duke supozuar që Kosova do të vazhdojë të ofrojë masa nxitëse për energjinë e ripërtëritshme nën një sistem të rishikuar, masat nxitëse për hidrocentralet duhet të përfundojnë në mënyrë që t'u jepet një shans teknologjive të tjera dhe të aplikohet një qasje e kujdesshme në lidhje me dëmet mjedisore.

Konkluzione dhe rekomandime

Me shumë gjasë, Kosova e ka përmbushur cakun e saj të përgjithshëm të energjisë së ripërtëritshme për 2020. Por, kjo ka ndodhur më shumë rastësisht se me paramendim, për shkak të rishikimit të të dhënave të biomases.

Kosova ka arritur progres shumë të dobët drejt përmbushjes së caktimit për energjinë e ripërtëritshme në transport dhe planet për t'u mbështetur në hidrocentralet të vogla për të rritur përqindjen e energjisë së ripërtëritshme në sektorin e energjisë elektrike nuk arritën të prodhojnë sasi të konsiderueshme të energjisë elektrike (2.3 për qind më 2019). Ndërkohë, hidrocentralet shkaktuan dëme serioze mjedisore dhe pakënaqësi të madhe publike.

Përkundër rishikimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Energji të Ripërtëritshme më 2018, Kosova nuk arriti të ndërtojë kapacitete solare, të erës ose hidrocentralet të vogla sa ishte planifikuar fillimisht, dhe që nga viti 2019 kishte arritur të sigurojë vetëm 5.15 për qind të energjisë elektrike të ripërtëritshme - më pak se çdo shtet tjetër anëtar i Komunitetit të Energjisë, përveç Moldavisë.

E tërë periudha nga vendosja e caktimit të energjisë së ripërtëritshme më 2012 deri në vitin 2020 u karakterizua me anashkalim të vazhdueshëm të energjisë ripërtëritshme dhe fokus në planet për termocentralin me thëngjill Kosova e Re. Kapacitetet solare dhe të erës kanë filluar të shtohen vetëm tri apo katër vitet e fundit. Ndërsa tani fillon vendosjen e caqeve dhe planifikimin e energjisë deri në vitin 2030, Kosova mund, dhe duhet, të mësojë nga përvoja e kaluar, në mënyrë që ta përshpejtojë tranzicionin e saj dhe të sigurohet që kjo pranohet gjerësisht nga publiku.

¹⁰⁶ Balkan Green Energy News: *Kosova po kërkon investime në energjinë diellore përmes skemës së ankandëve, 28 nëntor 2017*

¹⁰⁷ Balkan Green Energy News: *Konsulentët kërkuar të ndihmojnë në iniciimin e ankandëve të energjisë së ripërtëritshme në Kosovë, 16 shtator 2019*

¹⁰⁸ Holanda për Bankën Botërore: *eC2: Konsulentit teknik, mjedisor dhe social kosovar për kapacitete solare, 16 tetor 2019*

¹⁰⁹ Rrjeti CEE Bankwatch, *Maqedonia e Veriut: Ankesa sfidon avantazhet e padrejta të subvencioneve për hidrocentralet, 1 korrik 2019.*

¹¹⁰ Zyra e Rregullatorit të Energjisë në Kosovë, *Vendimi V. 1321. 2020, 10 dhjetor 2020.*

Rekomandime për Qeverinë e Kosovës

- **Veproni në kohë** Miratimi i caqeve për vitin 2020 më 2012 dhe miratimi i PKVER më 2013 nuk ishte optimal, duke marrë parasysh se investimeve u duhen disa vite për t'u zbatuar. Për më tepër, kur u bë e qartë se gjërat nuk shkonin siç ishin planifikuar, PKVER është dashur të rishikohet shumë më herët se 2018. Në atë kohë, kishte shumë pak hapësirë për veprime që do të mund të kishin ndikim real deri në vitin 2020.
- **Merrni vendim politik për t'i ndjekur burimet e ripërtëritshme të qëndrueshme dhe eficiencën e energjisë, jo lëndët fosile.** Kosova sigurisht që do të mund të kishte bërë më shumë progres në energjinë e ripërtëritshme dhe eficiencën e energjisë nëse do të ishte përqendruar më shumë në këtë drejtim, në vend që të këmbëngulte vetëm në termocentral të ri me thëngjill. Idetë e futjes së gazit fosil në Kosovë mund të kenë efekt të ngjashëm të fokusit të tepërt në këtë fushë dhe të kenë ndikim të dëmshëm në zhvillimin e eficiencës së energjisë dhe burimeve të ripërtëritshme.
- **Mbani caqe të thjeshta.** Aprovimi i caqeve detyruese dhe caqeve indikative të energjisë së ripërtëritshme ishte gjest i mirë i vullnetit politik, por koha e kufizuar për të përmbushur të dy caqet e ndërlikoi situatën.
- **Planifikoni në mënyrë të barabartë energjinë e ripërtëritshme, ngrohjen/ftohjen dhe transportin.** Në periudhën deri në vitin 2020, asnjë prej këtyre fushave nuk kishte vëmendje të duhur, por së paku në sektorin e energjisë elektrike u krijua një skemë mbështetëse dhe u ndërtua një kapacitet i ri i kufizuar. Në sektorin e transportit nuk u shënuar pothuajse aspak progres, ndërsa në sektorin e ngrohjes theksi kryesor në PKVER ishte tek ekonomitë familjare që përdorin dru zjarri, për të cilat nuk ishin parashikuar masa të veçanta. Në Gjakovë u zhvillua një projekt i ngrohjes qendrore të biomasës por testimi filloi vetëm në vitin 2021,¹¹¹ prandaj ishte shumë vonë për të dhënë ndonjë kontribut në cak.
- **Energjia e ripërtëritshme nuk është ekuivalent i energjisë së qëndrueshme.** Vetëm për shkak se BE lejon që disa teknologji të llogariten në drejtim të caktuar të energjisë së ripërtëritshme, kjo nuk do të thotë që të gjitha ato janë automatikisht të pranueshme nga ana mjedisore dhe shoqërore. Kosova tashmë e ka parë këtë për së afërmi me hidrocentralet e vogla, por teknologjitë e tjera si biomasa pyjore dhe biokarburantet gjithashtu ngrenë shqetësime, siç u përmend më lart. Prandaj, Kosova jo vetëm që duhet t'i kopjojë rregullat e BE-së, por duhet të mendojë për secilën teknologji specifike nëse ajo është me përfitim për Kosovën dhe, nëse po, në çfarë kushtesh.
- **Bëni plane reale.** Shtimi i 177 MW nga hidrocentralet e vogla në kapacitetin ekzistues të Kosovës nuk ka qenë real dhe është e paqartë se si u miratua një shifër e tillë. Pretendimet në lidhje me potencialin e disa teknologjive duhet të trajtohen me rigorozitet dhe duke pasur parasysh konsideratat mjedisore dhe sociale.
- **Sigurohuni që dokumentet e planifikimit janë të thjeshta dhe konsistente me njëri-tjetrin.** PKVER-të treguan se sa pritej të kontribuonte secila teknologji në caqet e vitit 2020, por më pas ishte Udhëzimi Administrativ 05/2017 që përcaktonte se çfarë niveli të tarifave nxitëse do të përfitonte secila teknologji. Përveç kësaj, Rregulla Nr. 10/2017 e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) për skemën e mbështetjes për prodhuesit e burimeve të ripërtëritshme të energjisë¹¹³ përcaktoi se cila madhësi e cilit lloj centrali do të mund të merrte tarifa nxitëse, por përsëri kjo nuk ishte në përputhje me atë që ishte parashikuar në PKVER për përmbushjen e caqeve për 2020.
- **Ndryshoni me kalimin e kohës.** Kosova ka favorizuar hidroenergjinë, duke lejuar që hidrocentralet të marrin më shumë tarifa nxitëse sesa era dhe dielli. Disa vjet më parë, kjo do të mund të ishte justifikuar me faktin se kapacitetet me erë dhe solare ishin të shtrenjta dhe për këtë arsye qeveria nuk mund të rrezikonte rritje të çmimeve të energjisë elektrike duke mbështetur instalime të konsiderueshme të këtyre teknologjive.

Por, kjo më nuk vlen, që disa vite, me rënien e çmimeve të erës dhe diellit. Megjithatë, në vitin 2017 Kosova rriti¹¹⁴ sasinë e energjisë hidrike që mund të mbështetet me masa nxitëse, në vend se ta zvogëlonte atë. Jo vetëm që dielli dhe era ofrojnë avantazhe mjedisore, por hidrocentralet janë gjithashtu gjithnjë e më të pasigurt, si pasojë e ndryshimeve klimatike dhe luhatjeve të të reshurave, siç është parë në vitin 2017 dhe në fillim të vitit 2019.

¹¹¹ Gjakova Portal, [Në Ngrrohtoren e Qytetit fillon testimi për prodhimin e energjisë elektrike nga biomasa, 27 maj 2021.](#)

¹¹² Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Kosovë: [Udhëzimi Administrativ \(MZHE\) nr. 05/2017 për Caqet e Burimeve të Energjisë së Ripërtëritshme](#)

¹¹³ Rregulla e ZRRE-së Nr. 10/2017, [Rregulla për skemën e mbështetjes për prodhuesit e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, 27 prill, 2017](#)

¹¹⁴ Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Kosovë: [Udhëzimi Administrativ \(MZHE\) nr. 05/2017 për Caqet e Burimeve të Energjisë së Ripërtëritshme](#)

- **Efiçienca e energjisë është lënda primare djegëse.** Reduktimi i humbjeve të larta në rrjetin e shpërndarjes në Kosovë (me nga gati 13 për qind për humbjet teknike dhe komerciale) ¹¹⁵ dhe izolimi i shtëpive do të bënin që nevojën për kapacitete të reja prodhuese të jetë më e menaxhueshme.
- **Përdorni pompat e ngrohjes.** Përdorimi i biomasës me gjasë do të vazhdojë të kufizohet gjithnjë e më shumë në BE në vitet e ardhshme për shkak të cilësisë së ajrit, emetimeve të gazrave serrë dhe dëmtimit të pyjeve. Kosova nuk duhet të mbështetet aq shumë në këtë burim për ngrohje dhe ftohje dhe duhet të bëjë më shumë për të nxitur përdorimin e gjerë të pompave të ngrohjes. ¹¹⁶
- **E ardhmja është elektrifikimi dhe përmirësimi i transportit publik.** Për arsye të përdorimit të tokës dhe qëndrueshmërisë, Kosova nuk duhet të shqetësohet me faktin që ende nuk ka përparuar në përdorimin e biokarburanteve. Në vend të kësaj, ai duhet të përqendrohet në përmirësimin e transportit publik dhe elektrifikimin e tij, duke përdorur burime të ripërtëritshme të energjisë.
- **Të marrim më shumë rreze dielli.** Në dokumentet strategjike si Plani i ardhshëm Kombëtar i Energjisë dhe Klimës, kushtoni më shumë vëmendje përdorimit të potencialit të konsiderueshëm, por tejet të nën-përdorur, të energjisë solare për prodhimin e energjisë elektrike dhe për ngrohje.
- **Jepni një shans prosumuesve.** Edhe pse në Ballkanin Perëndimor kanë filluar të zhvillohen disa projekte të mëdha të energjisë së ripërtëritshme pa masa nxitëse, shumë projekte, veçanërisht ato më të vogla, me shumë gjasë do të kenë nevojë për skema mbështetëse në vitet në vijim. Një tranzicion drejt një sektori energjetik me efiçencë të energjisë i bazuar në forma të qëndrueshme të energjisë së ripërtëritshme kërkon mbështetje për ekonomitë familjare dhe komunitetet që të përfshihen në prodhimin e energjisë, në mënyrë që të ketë pranim publik të tranzicionit dhe të sigurohet që energjia elektrike prodhohet sa më shume aty ku konsumohet.
- **T'i jepet fund masave nxitëse për teknologjitë e maturuara, siç janë hidrocentralet.** Vetëm teknologjitë të cilat janë ende në zhvillim dhe kostot e të cilave pritet të bien më tej kanë nevojë për mbështetje përmes ndihmës shtetërore, veçanërisht kapacitetet solare dhe të erës, në rastet kur ato nuk do të ishin të zbatueshme pa masa nxitëse.
- **Të ndryshohet përkufizimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë.** Ligji për Energjinë duhet të jetë në përputhje me përkufizimin e BE-së.
- **Të ndalen masat nxitëse për djegien e mbeturinave.** Të fshihet dispozita në Ligjin për Energjinë Elektrike që lejon prodhuesit e energjisë nga mbeturinat të bëhen Prodhuues të Kualifikuar.
- **Të aplikohen kritere të qëndrueshmërisë.** Minimalisht, të përfshihen në legjislacion klauzolat nga EEAG dhe Direktiva e Energjisë së Ripërtëritshme II që përcaktojnë kufizime mjedisore për burime të ndryshme të energjisë së ripërtëritshme, si mbeturinat, biomasa dhe hidrocentralet. Preferohet të përfshihen kritere më të rrepta më të përshtatshme për përvojën e Kosovës.

¹¹⁵ Zyra e Rregullatorit të Energjisë, [Raporti Vjetor 2019, mars 2020](#).

¹¹⁶ Për më shumë propozime për ngrohje, shih [Rrjetin CEE Bankwatch](#), [Ngrahja në Ballkanin Perëndimor - Përmbledhje dhe rekomandime për zgjidhje të pastra, maj 2021](#).

- **Skemat mbështetëse duhet të jenë të qëndrueshme nga ana mjedisore dhe ekonomike.** Të aplikohen ankande për teknologji specifike për masa nxitëse për të gjitha centralet solare dhe të erës më të mëdha se 1 MW, në përputhje me EEAG.¹¹⁷ Mos i rivendosni tarifatat nxitëse për centralet më të mëdha se maksimumi prej 500 kW¹¹⁸. Ankandet duhet të përfshijnë tiparet e mëposhtme:
 - Të ashtuquajturat kritere dytësore, për të siguruar qëndrueshmëri mjedisore dhe sociale të projekteve, kryesisht përmes përzgjedhjes së lokacioneve të përshtatshme për infrastrukturë të energjisë. Ata nuk duhet të vendosen në zona të mbrojtura ose zona të tjera të ndjeshme që duhet të mbrohen, p.sh. në kuadër të Direktivave të BE-së për Natyrën dhe Habitatet dhe nuk duhet të kenë ndikime negative në aktivitetet ekonomike që realizohen nga popullata lokale, si turizmi ose bujqësia.
 - Kriteret e pranueshmërisë që sigurojnë që mund të kualifikohen për masa nxitëse projektet e promovuara nga kooperativat e energjisë ose komunitetet lokale.
 - Ankandet duhet të jenë të ashtuquajturat ankande të vonshme, pasi të jenë marrë lejet dhe miratimet përkatëse, përfshirë vlerësimet mjedisore, lejet e ndërtimit dhe aprovimet për lidhje në rrjet dhe të jenë zgjidhur plotësisht çështjet pronësore.
- **Të aplikohen skema tregtare ose tregtime të emetimeve për emetimet e CO₂.**¹¹⁹ Të ardhurat për buxhetin e shtetit nga një sistem i tillë mund të përdoren për të nxitur eficientësinë e energjisë në ekonomi familjare dhe zhvillimin e formave të qëndrueshme të energjisë së ripërtëritshme.
- **Të ndalohen stimujt ekzistues për projektet mospërputhëse.** Shqyrtoni projektet e vazhdueshme të hidrocentraleve dhe sigurohuni që atyre që nuk përmbushin kriteret për stimuj nuk u lëshohen më tarifatat nxitëse.
- **Hapeni tregun e energjisë elektrike të Kosovës** sa më shpejt, për t'i shfrytëzuar sinergjitë rajonale. Lidhja me Shqipërinë, për shembull, do ta bëjë shumë më të lehtë për Kosovën që të integrojë sasi më të mëdha e të ndryshme të burimeve të ripërtëritshme në rrjet.

Rekomandimet për Komisionin Evropian

- **Ndihmoni Kosovën që të sigurojë që burimet e ripërtëritshme janë ekuivalente me burime të qëndrueshme.** Të përshejtohet ndihma për Kosovën për të përditësuar legjislativën e saj të energjisë së ripërtëritshme, duke i përfshirë kriteret e qëndrueshmërisë dhe dispozitat për prosumuesit. Të sigurohet që centralet e energjisë së ripërtëritshme që nuk janë në përputhje me direktivat e BE-së të mos kualifikohen për masa nxitëse.¹²⁰ Ndihmoni Kosovën që t'i marrë parasysh konsideratat e mësipërme në PKVER dhe planifikimin e saj për masa nxitëse.
- **Trajtoni mungesën e balancit.** Të sigurohet që çdo mekanizëm i ri mbështetës i zbatuar në Kosovë balancon mbështetjen e deritanishme joproporcionale për hidrocentralet krahasuar me atë për kapacitetet solare dhe me erë.
- **Tregoni se ndihma shtetërore ka rëndësi.** Të rriten përpjekjet për të zbatuar dispozitat e ndihmës shtetërore të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit të Kosovës dhe të mbështeten dispozitat e zgjeruara të ndihmës Shtetërore në Komunitetin e Energjisë. Kjo duhet të përfshijë njoftimin e ndihmës së propozuar për Sekretariatit dhe gjatë financiare për shkeljet e rregullave të Komunitetit të Energjisë.
- **Mbështeteni çmimin e karbonit.** Inkurajoni Kosovën që të aplikojë një taksë mbi CO₂ në mënyrë që të ofrojë kushte të barabarta për prodhimin e energjisë së ripërtëritshme dhe eficientësinë e energjisë.
- **Rekomandoni strategji/politika të suksesshme** dhe lidhni Kosovën me të tjerët që kanë sukses. Si organizatë që monitoron progresin e vendeve të tjera në çështjet e energjisë dhe me anëtarë që kanë qenë shumë të suksesshëm në rregullimin e prodhimit të energjisë në vendin e tyre, bashkëpunoni me politikëbërësit e Kosovës dhe sillni ekspertizë dhe sugjerime që do t'i udhëzonin politikëbërësit drejt një rruge më të qëndrueshme, duke marrë parasysh aftësitë dhe rrethanat e Kosovës.

¹¹⁷ Me përjashtim të centraleve me erë, të cilat mund të kenë një prag deri në 6 turbina ose 6 MW, cilado që është më e lartë.

¹¹⁸ Sipas EEAG, turbinat me erë mund të marrin tarifa nxitëse deri në një prag prej 3 turbinave ose 3 MW, cilado që është më e lartë.

¹¹⁹ Fushëveprimi do të jetë objekt diskutimi i mëtejshëm, por së paku duhet të mbulojë industrinë kryesore me emetim të lartë.

¹²⁰ Si EEAG ashtu edhe RED II kufizojnë masat nxitëse për centralet me djegie të mbeturinave në rrethana kur ato janë në kundërshtim me qëllimet e ekonomisë qarkore. I tillë do të ishte rasti për çdo central të mbeturinave në Kosovë që përdor mbeturinat komunale, duke pasur parasysh mungesën e riciklimit në vend.

- **Përshtateni këshillimin sipas realitetit në Kosovë** dhe priorizoni prioritetet e kërkesave për vendin sipas nevojave të tij dhe asaj që do të sillte rezultat më të mirë në drejtim të sigurimit të tranzicionit të qëndrueshëm të energjisë.

Rekomandime për Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë

- **Ndihmoni Kosovën të sigurojë që burimet e ripërtëritshme janë ekuivalente me burime të qëndrueshme.** Vazhdoni ndihmën për Kosovën në përditësimin e legjislacionit të saj të energjisë së ripërtëritshme, përfshirë kriteret e qëndrueshmërisë dhe dispozitat për prodhuesit, dhe zhvillimin e PKVER të saj. Sigurohuni që centralet e energjisë së ripërtëritshme që nuk janë në përputhje me Direktivat e BE-së nuk kualifikohen për masa nxitëse dhe se Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës në Kosovë i merr parasysh kufizimet e qëndrueshmërisë mjedisore dhe ekonomike të burimeve të ripërtëritshme të energjisë.
- **Trajtoni mungesën e balancit.** Të sigurohet që çdo mekanizëm i ri mbështetës i zbatuar në Kosovë balancon mbështetjen e deritanishme joproporcionale për hidrocentralet krahasuar me atë për kapacitetet solare dhe me erë.
- **Vazhdoni të tregoni se ndihma shtetërore ka rëndësi.** Përpyekjet e Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë janë marrë seriozisht nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore në Kosovë dhe kjo duhet të vazhdojë.
- **Përshtateni këshillimin sipas realitetit në Kosovë** dhe priorizoni prioritetet e kërkesave për vendin sipas nevojave të tij dhe asaj që do të sillte rezultat më të mirë në drejtim të sigurimit të tranzicionit të qëndrueshëm të energjisë.

Rekomandimet për IFC dhe BERZH

- Gjatë realizimit të asistencës së politikave për Kosovën në çështjen e ankandeve të energjisë së ripërtëritshme, sigurohuni që pranueshmëria mjedisore është përfshirë në procesin e përzgjedhjes së projektit.
- Stimujt e hidroenergjisë duhet të largohen në tërësi, duke pasur parasysh mungesën e potencialit të qëndrueshëm në Kosovë dhe nivelet e larta të mosrespektimit të legjislacionit mjedisor në të gjithë rajonin.

Rekomandimet për organizatat e shoqërisë civile në Kosovë

- Të angazhohen aktivisht në komunikimin me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për të mundësuar një planifikim më të mirë dhe më transparent të energjisë dhe për të lëvizur më shpejtë drejt një sistemi mbështetës të energjisë së ripërtëritshme që është i qëndrueshëm në aspekt mjedisor dhe ekonomik.
- T'i ndjekin dhe paraqesin para opinionit të Kosovës trendet globale të lidhura me energjinë e ripërtëritshme, ndryshimin klimatik dhe mbrojtjen e mjedisit. Të kontaktohen kolegët jashtë vendit për të siguruar një vështrim të përditësuar dhe kritik të zhvillimeve të reja në sektorin e energjisë në mënyrë që t'i kuptojmë përparësitë dhe mangësitë e zgjidhjeve të ndryshme, duke përfshirë bioenergjinë, hidrogjenin dhe karburantët sintetikë. Të alarmohen situatat kur autoritetet veprojnë mbi zgjidhje të rreme.
- Të kërkohet llogari nga autoritetet për lejimin joadekuat të projekteve të energjisë. Për shembull, nëse lejet mjedisore janë të obligueshme për hidrocentrale ose centrale të tjera energjetike, por ato kanë skaduar ose nuk janë siguruar, shoqëria civile duhet të sigurohet se janë ndërmarë veprime zbatimi dhe se ZRRE do t'i ndërpresë tarifat stimuluese për centralet mospërbushëse tashmë të ndërtuar.
- Të organizohen aktivitete që ngrisin ndërgjegjësimin publik mbi rëndësinë e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe eficiencën e energjisë, si dhe mënyrën se si mund të bëhen investime dhe të sigurohet qasje në fonde. Kjo do t'i informojë dhe inkurajojë qytetarët që të marrin pjesë dhe të kërkojnë ndryshime nga institucionet përgjegjëse - qasje nga poshtë-lart që siguron rezultate afatgjata.
- Vazhdoni t'ia përkujtoni qeverisë se ata duhet të bëjnë më shumë dhe ta vazhdojnë diskutimin. Duhet të flasim më shumë për energjinë e ripërtëritshme në Kosovë - vazhdoni të jeni të zëshëm në mënyrë që ta mbajmë gjallë këtë diskutim.



Funded by
the European Union

“Ky publikim është botuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e BIRN Kosova, CEE Bankwatch, ERA Group dhe TV Mreza dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.”

